

# Bankieri

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Nr. 6 Janar 2013


ISSN 2225-2959  
9 772225 295004



**CILËSIA E HUAS...  
ose guri i themelit!**



**ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS**  
**SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE**



**Ndërtojmë mundësi të reja drejt edukimit financiar!**

Këtë vit me iniciativa të reja!

AAB do të vazhdojë të promovojë aktivitetet në fushën e edukimit financiar.

ANËTARËT E AAB

ALPHA BANK	BKT BANKA KOMBETARE TREGTARE	CREDINS bank	CBA CREDIT BANK OF ALBANIA BANKA E KREDITIT TE SHOPERISE
CRÉDIT AGRICOLE	Fibank First Investment Bank	Banka Nderkombetare Tregtare International Commercial Bank	INTESA SANPAOLO BANK Albania
NBG Bank	ProCredit Bank	Raiffeisen BANK	SOCIETE GENERALE ALBANIA
TIRANA BANK	UNION BANK	UBA United Bank of Albania Banka e Bashkuar e Shqiptare	VENETO BANKA GRUPPO VENETO BANCA

# Përmbajtja

## EDITORIAL

Cilësia natyrale dhe cilësia sintetike  
nga *Elvin MEKA*

f.5

## TEMA E DITËS

Cilësia e huave bankare - kushti bazë për një veprimtari  
bankare të qëndrueshme nga *Bledar SHELLA*

f.6

Huadhënia cilësore

f.9

Sfida e përhershme e sektorit bankar

Rënia e huadhënies, jo për "faj" të bankave  
nga *Aurora SULÇE*

f.11

## INTERVISTA

"Veneto Banka...shpaloset!"  
Intervistë me *Z.Lucio GAITA*

f.13

## SISTEMI BANKAR

Rreziku operacional: një rrezik i ndërlikuar që  
duhet menaxhuar me kujdes nga *Erinda DOÇI*

f.14

Sfida e informimit të individëve për hua nga  
bankat në Shqipëri nga *Gentiana DUKA*

f.17

## FORUMI I EKSPERTËVE

Ndërtimi i normave të interesit për hua bankare  
nga *Spiro BRUMBULLI*

f.19

Komunikimi dhe rëndësia e tij në sektorin bankar  
nga *Frida KRIFCA*

f.22

## KËNDI I EKONOMISTIT

Bashkimi bankar europian - ndërmjet realitetit dhe  
utopisë nga *Adrian CIVICI*

f.25

## PËRGJEGJSHMËRIA SOCIALE

Auditimi i përgjegjësisë sociale të korporatave në  
sektorin bankar shqiptar nga *Holtjana BELLO*

f.28

Aktivitet nga *Bankat*

f.30

## NJË BANKIER NDRYSHE

*Plator Ulqinaku, bankieri me pasionin për poezinë*

f.33

## RRJETI BALLKANIK

Lajme ndërballkanike

f.35

## TEKNOLOGJI

Portali i ri online "aab-ankande.com"  
nga *Brunilda KOSTARE*

f.39

## AUDITORI FINANCIAR

Pesë K-të e analizës së huas  
nga *Junida TAJAJ (Katroshti)*

f.40

## SPECIALE

"Historiku i Bankave në Shqipëri", promovimi i librit,  
04 dhjetor 2012

f.41

## AAB

Aktivitetet e Shoqatës Shqiptare të Bankave

f.42



BANKIERI është publikimi më  
i ri zyrtar i Shoqatës Shqiptare  
të Bankave i cili do t'i dedikohet  
kryesisht sektorit bankar shqiptar.  
BANKIERI do t'i japë lexuesit  
një informacion të vlefshëm mbi  
arrijet e industrisë në përgjithësi  
dhe të bankave tregtare në  
veçanti.

## Bankieri

Nr. 6, janar 2013

## Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

### Redaksia:

Elvin Meka

Kryeredaktor

Eftali Peçi

Koordinatorë Produksioni

Junida Tafaj (Katroshti)

Bashkëpunëtorë

Sonila Krashi

Design & Layout

Anduena Manushi

Redaktore

Gert Hoxha

Fotograf

Shtypi:  Gent-grafik

## Bordi Editorial:

Seyhan PENCABLIGIL

Kryetar i AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm,  
Banka Kombëtare Tregtare

Ioannis KOUGIONAS

Nënkryetar i AAB - së & Drejtor i Përgjithshëm,  
NBG Bank Albania

Christian CANACARIS

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së &  
Drejtor i Përgjithshëm, Raiffeisen Bank

Flutura VEIPI

Anëtare e Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtuese e  
Drejtorisë Ekzekutive, Procredit Bank

Bozhidar TODOROV

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm  
Banka e Parë e Investimeve - Shqipëri

Periklis DROUGKAS

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm  
Alpha Bank Albania

Endrita XHAFERAJ

Sekretare e Përgjithshme, Shoqata Shqiptare e Bankave

Hysen ÇELA

Kryetar i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar,

Adrian CIVICI

President & Drejtor i Shkollës Doktorale  
Universiteti Europian i Tiranës

Spiro BRUMBULLI

Rektor - Tirana Business University

Enkeleda SHEHI

Kryetare e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare

## SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", KULLAT BINJAKE  
Kulla I, Kati 6-të, A3, Tiranë

Tel: +355 4 2280 371; Fax: +355 4 2280 359

E-mail: bankieri@aab-al.org; www.aab.al

Festojmë

*15 Vjet*  
NË SHQIPËRI

Gjithmonë të sigurt, gjithmonë bashkë



ALPHA BANK

☎ 042 240 477 🖱 [www.alphabank.al](http://www.alphabank.al)

## CILËSIA NATYRALE DHE CILËSIA SINTETIKE



nga Dr. Elvin MEKA<sup>1</sup>  
Kryeredaktor

Erërat që na fryjnë nga perëndimi e jugu janë të ftohta dhe ende ndjejmë shijen e hidhur të problemeve të shkaktuara nga sektori i ndërtimit dhe pasurive të patundshme, por gjithsesi cilësia e analizës së huas vijon të mbetet guri i themelit për veprimtarinë bankare dhe kjo është në një simbiozë të përhershme me menaxhimin cilësor të rrezikut.

**J**a ku mbërritëm në fund të vitit të vjetër dhe në fillim të vitit të ri, por ende të gjithë dëgjojmë të njëjtën këmbanë që bie: huat me probleme... tkurrje të huave! Po, po e dëgjuat saktë, kjo është një këmbanë që bie! Tingulli i saj dëgjohet dhe komentohet kudo, kur hapet e lexohet një gazetë, faqe interneti, apo në çdo stacion televiziv që shfaqet, kur shtypet çdo lloj butoni në telekomandë. Tashmë prania e saj është një fakt i jetës, jeta vazhdon dhe duhet të përballemi e të jetojmë me këtë fakt.

U bë kohë që sistemi bankar po ecën përmes vështirësive, pasi ekonomia vazhdon të lundrojë në ujëra të cekëta, ndërkohë që cilësia e disa klasave të aktiveve, veçanërisht e huave për banesa dhe pasuri të patundshme, por jo vetëm, është përqësuar deri në atë pikë sa e ka sjellë normën e huave me probleme në nivelin 23 për qind. Konkretisht, bankat janë përpjekur fort për katër vjet me radhë, që të menaxhojnë huat me cilësi të dobët, të mirëadministrojnë fitimet jo shumë të larta madje dhe humbjet, të ndjekin procedurat pambarim të ekzekutimit të kolateraleve dhe të ristrukturojnë huat problematike, e të gjitha këto në kuadër të një panorame jo shumë të sigurt të kushteve ekonomike në të ardhmen. Sigurisht, mjaftueshmëria e kapitalit, mbetet vija e parë e mbrojtjes, por bankingu nuk është ai lloj mekanizmi që thith gjithnjë e pa fund parë nga xhepat e aksionarëve. Bankingu është biznesi i parave, me parë dhe për parë.

E meqë është biznesi i parave, por kryesisht me paratë e të tjerëve, rregullat e kujdesit, si rregull, duhet të jenë në themel të kësaj veprimtarie. Bankat në Shqipëri nuk mund t'i shpëtojnë zbatimit

praktik të këtyre rregullave të arta dhe universale, madje këto rregulla mund të shpjegojnë lehtësisht çdo gjë, kudo dhe në çdo kohë. Nga zhvillimi ekonomik dhe historia e njëqind viteve të fundit kemi mësuar elementët klasikë që shoqërojnë një krizë financiare:

- (1) përdorimi i tepruar i levës financiare,
- (2) investimi dhe ekspozimi i tepruar në pasuri të patundshme,
- (3) menaxhimi e analiza e dobët e rrezikut.

Për fat të mirë dhe praktikisht, sistemi ynë bankar është larg përdorimit të tepruar të levës financiare, pasi ky sistem ka rrënjë të thella në modelin tradicional e klasik të bankingut e të financimit, por kur është fjala për elementet e tjera, realiteti qëndron përpara nesh, ashtu siç ai është objektivisht.

Erërat që na fryjnë nga perëndimi dhe jugu, janë të ftohta dhe ende ndjejmë shijen e hidhur të problemeve të shkaktuara nga sektori i ndërtimit dhe pasurive të patundshme. Megjithatë, cilësia e analizës së huas vijon të mbetet guri i themelit për veprimtarinë bankare dhe kjo është në një simbiozë të përhershme me menaxhimin cilësor të rrezikut. Sigurisht që kjo e fundit është asi nën mëngë për një biznes të suksesshëm, të fortë e të qëndrueshëm në kohë, por çështja nuk është hyrja në lojë, por luajtja me gjakftohtësi, mençuri dhe fitimi i saj në fund. Thënë më thjesht, zotërimi i një portofoli huash gjithnjë cilësor, është çelësi për të përballuar tallazet ekonomike dhe përpjekja për ta mbajtur artificialisht cilësor atë nuk të çon larg!

<sup>1</sup> Përgjegjës i Departamentit të Financës, UET

## CILËSIA E HUAVE BANKARE: KUSHTI BAZË PËR NJË VEPRIMTARI BANKARE TË QËNDRUESHME



**nga Bledar SHELLA, CFA**  
Drejtor i Divizionit të Riskut  
Societe Generale – Shqipëri

Sot, si kurrë më parë, në vëmendje të gjithsecilit është cilësia e dobët e portofolit të huave. Kjo pjesërisht për shkak të krizës financiare botërore, e ardhur kryesisht nga huadhënia e shkujdesur i bankave, por më tepër dhe për shkak të nivelit shqetësues të huave me probleme në sistemin tonë bankar, që në nëntor 2012 arriti në 23%. Ky nivel i lartë i huave me probleme, së bashku me situatën jo të favorshme ekonomike që po kalojmë, si dhe parashikimet jo shumë pozitive për vitin në vijim, ka bërë që shumë banka të ngurrojnë në huadhënie dhe të shpenzojnë shumë prej energjive të tyre në mbledhjen e këtyre huave me probleme. Kjo ndodh, pikërisht, në momentet kur ekonomia ka më tepër nevojë për një stimul dhe vazhdim të huadhënies.

Vitet e fundit ishin për të gjitha bankat e sistemit tonë bankar vite të vështira. E njëjta vështirësi pritet të vijojë të paktën edhe këtë vit. Megjithatë, krahas problemeve që mundën të përballonin e atyre që

Standardet më të mira të huadhënies, monitorimi dhe veprimi i shpejtë e i koordinuar, mund të ndihmojnë në daljen me dëme minimale nga situata e vështirë aktuale, si dhe të ndërtohet rruga për një sistem bankar edhe më të shëndetshëm

mund të shfaqen në vijim, një gjë është e sigurt, që të gjithë jemi në një proces ndryshimi dhe mënyra se si përballohet ai, është thelbi i identikitit të secilit prej bankave.

Andrew Sheng, një ndër njohësit më të mirë të krizave globale financiare, në fjalimin e tij mbi rëndësinë e menaxhimit të rrezikut citonte: “Kriza financiare është një ngjarje, ristrukturimi i bankave që e pason atë është një proces”. Në këtë proces

Në këtë dinamizëm të shpejtë rritjeje të huadhënies u “harruan” parimet bazë të huadhënies, sikundër janë:

- (1) natyra ciklike e ekonomisë,
- (2) domosdoshmëria për të shmangur përqendrimin dhe
- (3) shtrirja e menaxhimit të rrezikut në të gjithë organizatën.

kompleks, por të nevojshëm, gjykoj se po kalojnë tashmë të gjitha bankat e sistemit tonë bankar, ku më pak e ku më shumë, të gjitha po prekin sot ndryshimin.

Për secilën nga bankat, e rëndësishme është të kryejë një analizë të faktorëve që na sollën në këtë situatë negative, të nxjerrë mësim dhe t'i zbatojë ato, në mënyrë që gabime të ngjashme të mos përsëriten në vazhdimësi. Nëse bëjmë një diagnostikim të faktorëve që çuan në situatën e sotme të cilësisë së portofolit të huave bankare, mund të citohen disa prej tyre:

1. moderimi i rritjes ekonomike të viteve të fundit dhe rënia e ndjeshme e sektorit të ndërtimit, mbeten faktorët më të rëndësishëm. Veçanërisht kjo e dyta, duke krijuar një rreth vicioz, e futi tregun në një vorbull mungese likuiditeti dhe pamundësie të pagesave të borxheve dhe detyrimeve. Por ky përkeqësim nxori në sipërfaqe një ndër problemet më të mëdha, që lidhet me përqendrimin e huave në sektorin e ndërtimit. Kjo ndoshta dhe për arsye se pjesa më e madhe e bizneseve të ashtuquajtura të fuqishme, nuk mund të mos ishin përfshirë në këtë sektor me marzhe të larta fitimi, por që sikundër u kuptua nga të gjithë, u zhyt në një gropë mungese likuiditeti, nga e cila do të dalë me shumë vështirësi.

Andrew Sheng, një ndër njohësit më të mirë të krizave globale financiare, në fjalimin e tij mbi rëndësinë e menaxhimit të rrezikut citonte: “Krizë financiare është një ngjarje, ristrukturimi i bankave që e pason atë është një proces”.

2. standardet e dobëta të huadhënies, të ndjekura nga disa banka gjatë kohës së boom-it të huadhënies, që favorizuan rritjen e shpejtë e të pakontrolluar të tyre. Këto hua, të dhëna për huamarrësit e dobët financiarisht, ishin “të maskuara”, për sa kohë huadhënia rritej me ritme të shpejta, por u kthyen në hua me probleme, sapo ritmet e huadhënies ranë dhe ekonomia pësoi tkurrje. Pjesa më e madhe e bankave nxituan të fitonin treg, duke rritur portofolat e tyre të huave dhe duke “harruar” kështu mirëmenaxhimin e rrezikut.

Në këtë dinamizëm të shpejtë rritjeje të huadhënies u “harruan” parimet bazë të huadhënies, sikundër janë:

- (1) natyra ciklike e ekonomisë,
- (2) domosdoshmëria për të shmanhur përqendrimin dhe
- (3) shtrirja e menaxhimit të rrezikut në të gjithë organizatën, duke u bërë kështu një zë i fortë në të.

Është ironike se si pikërisht neglizhenca në dhënien e pozicionit të duhur për menaxhimin e rrezikut, si një faktor përcaktues i cilësisë së portofolit të huasë, me qëllimin e përfitimit të sa më shumë pjesë të tregut, bëri që shumë banka të lëngojnë sot në një nivel shqetësues të huave me probleme, e për rrjedhojë, duke zvogëluar ndjeshëm edhe huadhënien. Megjithatë, tashmë pjesa më e madhe e dëmit është bërë, e ajo çfarë mbetet është nxjerrja e përfundimeve dhe marrja e masave të shpejta për të riparuar çka u dëmtua.



Përfundimi që nxirret lehtësisht nga të gjithë është se, cilësia e lartë e portofolit të huas mbetet një faktor i domosdoshëm e i përhershëm për zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit bankar dhe bankat kanë nevojë të zbatojnë në nivel organizate kulturën e menaxhimit të rrezikut. Bankat duhet të orientojnë e të zhvillojnë njëkohësisht shitjen dhe menaxhimin e rrezikut, e mundësisht të drejtojnë në një linjë këto dy elemente, duke i lidhur fort së bashku. Gjithashtu, ndihet nevoja për një koordinim politikash, strategjish e forcash, për të arritur cilësinë.

Për të pasur një portofol të shëndetshëm huash është e rëndësishme që të gjithë të ndihen pjesë e kësaj veprimtarie, duke menaxhuar rrezikun në çdo aspekt të punës së tyre të përditshme. Për të bërë të mundur një gjë të tillë, duhet që të gjithë punonjësit e një organizate të dinë qartë atë çfarë kërkohet prej tyre, si dhe dëshira e mundësia e organizatës për të pranuar dhe marrë përsipër rrezik t’u përcillet të gjithëve në mënyrë të qartë e të hapur. Për një organizatë biznesi, në rastin tonë një bankë, nuk ka asgjë më të keqe sesa ekzistenca e sinjaleve të brendshme konfuze, çka do të thotë paqartësi në veprime e vendime. Të gjithë duhet të njohin se çfarë pritet prej tyre e të shqyrtojnë më pas mënyrën më të mirë për ta arritur këtë. Cilësia e portofolit të huas ruhet nëse shitja dhe admini-

strimi i rrezikut ndajnë së bashku momente reflektimi dhe veprimi të njëkohshëm.

Sistemi bankar shqiptar ka kaluar kohë të vështira, të cilat ende nuk kanë mbaruar, por nëse të gjithë i rikthehen parimeve bazë që duhet të udhëheqin punën e bankierëve, e që janë standardet më të mira të huadhënies, monitorimi dhe veprimi i shpejtë e i koordinuar, i gjithë sistemi mund të përpiqet të paktën të dalë nga kjo situatë e vështirë me dëme minimale, si dhe të ndërtojë rrugën për një sistem bankar edhe më të shëndetshëm.

Cilësia e lartë e portofolit të huas është një faktor i domosdoshëm e i përhershëm për zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit bankar dhe bankat kanë nevojë të zbatojnë në nivel organizate kulturën e menaxhimit të rrezikut.



4 22 66 288 | [www.bkt.com.al](http://www.bkt.com.al)

# VENDI MË I SIGURTË PËR DEPOZITAT TUAJA



# HUADHËNIA CILËSORE

## Sfida e përhershme e sektorit bankar

Intervistë e disa bankierëve, dhënë kryeredaktorit të revistës “BANKIERI”

*Sa i rëndësishëm paraqitet për bankat krijimi i stokut të ri të huave cilësore? A është kriza globale financiare dhe ekonomike shkaktari kryesor i përqesimit të cilësisë së portofolit të huave bankare në Shqipëri?*



**Jola DIMA**  
Drejtoresh e Divizionit  
për Administrimin e Riskut,  
Intesa Sanpaolo Bank

*Krijimi i stokut të ri të huave cilësore është i rëndësishëm për bankat dhe gjithashtu për ekonominë në tërësi, në pikëpamjen e kreditimit të ekonomisë dhe në pikëpamjen e kostove.*

### JOLA DIMA

Krijimi i stokut të ri të huave cilësore është i rëndësishëm për bankat dhe gjithashtu për ekonominë në tërësi, në pikëpamjen e kreditimit të ekonomisë dhe në pikëpamjen e kostove. Kreditimi cilësor është themelor për uljen e kostove të huadhënies për ekonominë. Kriza globale, megjithëse në një nivel më të ulët, pa dyshim ka prekur ekonominë shqiptare, nëpërmjet uljes së dërgesave të emigrantëve, kostos së lartë të importeve (karburantet, energjia etj.). Megjithatë, Shqipëria ka pasur dhe çështjet e saj

të brendshme, lidhur me ineficiencën e sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, barrierat tatimore për pastrimin e portofoleve të bankës nga huat e këqija, si dhe kriza në sektorin e energjisë, që ka rritur trysinë e kostot për bankat dhe biznesin në këtë sektor.

### NDUE MALUTA

Krijimi i stokut të ri të huave cilësore merr një rëndësi të shumëfishtë për ekonominë shqiptare në tërësi e bankat në veçanti, pasi një portofol i shëndetshëm huash ndikon pozitivisht në bilancin e bankave, ul nivelin e huave me probleme, rrit vlerësimin e bankave në arenën ndërkombëtare, çka përkthehet në një rritje të besueshmërisë së depozituesve dhe rritje të mundësive për burime financiare me kosto më të ulët nga partnerët ndërkombëtarë. Një nga pasojat e krizës është rëndimi i situatës financiare të emigrantëve shqiptarë, çka sjell ulje në aftësinë paguese të një pjese të huamarrësve në sektorin bankar në Shqipëri.

### AIDA LALA

Rritja e portofolit të ri dhe cilësor e bën më të shëndetshëm portofolin e huas, ku në kreditimin e klientëve të rinj banka i kushton rëndësi analizës financiare të kujdesshme. Lidhur me periudhën aktuale, kur kriza financiare dhe ajo e borxheve ka mbërthyer zonën euro, ekonomia shqiptare ndjen vështirësi, të cilat pasqyrohen në ritmet e rritjes ekonomike, gjendjen financiare të individëve/familjeve, bizneseve si dhe konsumin e tërhequr. Për më tepër, individët dhe bizneset e shprehin qartë hezitimin për të ndërmarrë angazhime afatgjata, që nënkupton një tkurrje reale të aktivitetit të huadhënies nga bankat.



**Ndue MALUTA**  
Drejtor i Grupit  
të Menaxhimit të Riskut,  
Banka Kombëtare Tregtare, BKT

*Për të krijuar një portofol cilësor të huave bankat duhet të tregohen të kujdesshme në përzgjedhjen dhe analizën e klientëve të rinj, si dhe të përmirësojnë teknikën e menaxhimit të portofolit ekzistues.*

### SERDAR EGELI

Krijimi i stokut të ri e cilësor të huave është shumë i rëndësishëm për bankat, pasi huadhënia është burimi kryesor i fitimit për to. Kriza globale financiare dhe ekonomike është një kontribuues kryesor për përqesimin e portofolit të huave, pasi ka krijuar një mjedis me besim të ulët të konsumatorëve, që ka zvogëluar ndjeshëm kërkesën për të mira e shërbime që ofron sektori real i vendit. Duhet theksuar se gjatë viteve 2000-2008, u krijua një ofertë e tepërt në sektorin e pasurive të patundshme dhe shumë sektorë të lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi me zhvillimet në këtë fushë janë dëmtuar seriozisht nga ulja e papritur dhe drastike e kërkesës, pas shpërthimit të krizës globale.

**Çfarë përpjekjesh bën banka juaj për sigurimin e një mbarëvajtjeje të qëndrueshme të cilësisë së portofolit të huave dhe si arrihet kjo?**

JOLA DIMA

Banka po punon në dy drejtime:

- (1) zvogëlimi i stokut aktual të huave me probleme, nëpërmjet agjencive të arkëtimit dhe strukturave të dedikuara të përmirësuar brenda bankës dhe
- (2) sigurimi i një portofoli të ri cilësor, duke trajtuar paraprakisht shumë çështje të evidentuara në të shkuarën dhe monitorimin e kujdesshëm të tyre. Banka po harton procese të reja kreditimi, rregulla dhe produkte për segmente të rëndësishme, që po mbështeten me zhvillime dhe asistencë të dedikuara teknologjike. Gjithashtu, rritja e nivelit të njohurive të bankës për nevojat e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë dhe rreziqeve përkatëse do të pasqyrohet në forma më të përshtatshme financimi, për këta sektorë të ekonomisë, si dhe për segmente apo madhësi të ndryshme të klientëve.



**Serdar EGELI**

Drejtuës i Përgjithshëm i Korporatave,  
NBG Bank Albania

*Problemet e borxheve të larta, rritjes së ulët ekonomike dhe procesi i rikapitalizimit në bankat e vendeve të zhvilluara me qëllim përmirësimin e niveleve të mjaftueshmërisë së kapitalit, do të kushtëzojnë sfidat për ekonominë shqiptare në drejtim të tërheqjes së IHD-ve.*

NDUE MALUTA

Për të krijuar një portofol cilësor të huave bankat duhet:

- (1) të tregohen të kujdesshme në përzgjedhjen dhe analizën e klientëve të rinj, përmes diversifikimit të portofolit dhe fokusimit në sektorë me më pak rrezik e me potencial të madh zhvillimi si dhe
- (2) të përmirësojnë teknikat e menaxhimit të portofolit ekzistues, nëpërmjet rishikimit dhe adaptimit të planeve të shlyerjes së huave me probleme, duke përdorur teknikat e ristrukturimit, riskedulimit, periudhat "grace" të kryegjësë, apo planet shtesë për shlyerje, shitje pjesore të kolateralit, pa kaluar në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm.

SERDAR EGELI

Banka ka ndërmarrë përmirësime procedurale dhe organizative, për të kontrolluar e përmirësuar cilësinë e portofolit të huave, si dhe për të siguruar krijimin e praktikave të qëndrueshme të huadhënies cilësore.

AIDA LALA

Në vitin 2011 banka realizoi riorganizimin e Divizionit të Kredisë, duke iu përshtatur situatës së vështirë ekonomike dhe kushteve të reja të tregut. Çdo degë e bankës ka një specialist të dedikuar, i specializuar të ndjekë në vijim dhe të gjejë zgjidhje, në mënyrë që situata të mos përkeqësohet. Vë-



**Aida LALA**

Drejtores e Drejtorisë së Rikuperimit  
të Kredive me Probleme  
Credins Bank

*Kriza po i shtyn bizneset t'i kushtojnë më shumë vëmendje rritjes së produktivitetit, duke shtuar efikasitetin, në drejtim të uljes së kostos së punës dhe duke bërë lëvizje më të zgjuara, për të tërhequr klientë me sa më pak kosto, ndërsa nuk ka investime agresive në teknologji*

mendje i kushtohet parandalimit të vonësave, nëpërmjet:

- (1) menaxhimit prej momentit të parë të shfaqjes së problemit,
- (2) vizitave të përfaqësuesve të bankës në mjediset e biznesit dhe
- (3) gjetjes së zgjidhjeve në funksion të bashkëpunimit të mëtejshëm me klientin.

**Sa e vështirë bëhet kjo sfidë në kushtet e sotme të vazhdimin të krizës ekonomike dhe financiare në Europë dhe efekteve të saj në ekonominë shqiptare?**

ERVIN XHOMO

Drejtor i Divizionit të Korporatave  
Intesa Sanpaolo Bank

Në aspektin material, kjo lidhet ngushtë me faktin që Italia dhe Greqia, janë dy ekonomitë me peshën më të madhe në shkëmbimet ekonomike me Shqipërinë, nga pikëpamja e IHD-ve dhe të qenit destinacioni kryesor për eksport-importin e produkteve shqiptare. Në aspektin psikologjik, perspektiva europiane ka ndikuar negativisht në klimën e biznesit dhe synimin e tij për të kryer investime të reja dhe klimën e tregut konsumator dhe syni-

min e familjeve për konsum të përditshëm dhe investime personale.

NDUE MALUTA

Megjithëse kriza ekonomike në Europë është drejt përfundimit, në vendin tonë ajo është ende e evidente dhe në një periudhë afatmesme situata parashikohet të mbetet e njëjtë, kryesisht nga niveli i lartë i papunësisë dhe prirjes për rritje të borxhit publik, që është bërë shkak dhe për rritjen e deficitit buxhetor. Gjithashtu, parashikohen investime publike në nivel të ulët për mungesë likuiditeti, pakësimi i konsumit individual, rënie e eksport-

teve, sidomos në industrinë fason dhe të lëndëve të para, si dhe tkurrje të IHD-ve.

SERDAR EGELI

Presim që sfidat të vijojnë edhe përgjatë vitit 2013, brenda e jashtë vendit. Problemet e borxheve të larta në eurozonë, rritjes së ulët ekonomike kudo dhe procesi i rikapitalizimit në bankat e vendeve të zhvilluara, me qëllim përmirësimin e niveleve të mjaftueshmërisë së kapitalit do të kushtëzojnë sfidat për ekonominë shqiptare në drejtim të tërheqjes së shumë të kërkuarave IHD. Situata në Europë do të vazhdojë të ndikojë në prirjen rënëse të dërgesave të emigrantëve në 2013-ën e kjo mund të krijojë trysni në normat e këmbimit dhe të çojë në një zhvlerësim të moderuar të lekut në vijim.

AIDA LALA

Tashmë jemi në një situatë ku njihen problemet që po kalon individit dhe biznesi. Detyrimet i qeverisë për firmat e ndërtimit të angazhuara në ndërtimin e infrastrukturës publike, i ka venë në vështirësi ato. Një pjesë e bizneseve po e përballojnë këtë situatë duke diversifikuar portofolin e investimeve, disa të tjerë po diversifikojnë partnerët dhe të tjerë kanë "ngrirë" aktivitetin ekonomik, ose kanë ulur numrin e punonjësve. Kriza po i shtyn bizneset t'i kushtojnë më shumë vëmendje rritjes së produktivitetit, duke shtuar efikasitetin, në drejtim të uljes së kostos së punës dhe duke bërë lëvizje më të zgjuara, për të tërhequr klientë me sa më pak kosto, ndërsa nuk ka investime agresive në teknologji. Në këto kushte ajo çka vlerësohet është që bankat t'i gjenden klientëve pranë me zgjidhje, që ruajnë investimin e tyre dhe krijojnë të ardhura për shlyerjen e detyrimeve të huave.



## RËNIA E HUADHËNIES, JO PËR “FAJ” TË BANKAVE

Rënia e nivelit të huadhënies nuk është thelbësisht për “faj” të bankave dhe rritjes së shkallës së tyre të kujdesit, por një zgjedhje e detyruar që imponohet nga ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në vend dhe kohët e vështira që po kalon biznesi

nga Aurora SULÇE

Rënia e niveleve të huadhënies ka qenë ndër lajmet e pasqyruara gjerësisht në media gjatë gjithë tremujorit të kaluar. Dukuria ngjalli habi, pasi ndodhi për herë të parë pas shumë vitesh dhe mbi të gjitha për herë të parë, që prej fundit të 2008-ës, periudhë kur kriza ekonomike përfshiu Europën edhe globin. Në Shqipëri sistemi bankar rezistoi, e jo vetëm që gëzoi besimin e qytetarëve, por u bë mbështetësi dhe financuesi kryesor i rritjes ekonomike në një periudhë të vështirë për të gjithë botën. Huat njohën rritje të vazhdueshme, megjithëse me ritme më të moderuara, depozitat u rritën, gjithashtu dhe fitimi i sistemit bankar. Në këto kushte, rënia e huadhënies kërkon një analizë të plotë e më të thellë sesa thjesht komentimi përciptazi i shifrave, që devijuan nga trajektorja.

Të gjithë bien dakord se ekonomia shqiptare vuan aktualisht efektet e krizës europiane që ka goditur kryesisht dy partnerët kryesorë tregtarë, Italinë dhe Greqinë. Kërkesa e jashtme ka rënë dhe biznesi ndodhet në vështirësi, duke bërë që shumë prej tyre të mos respektojnë kontratat me bankat e të mos kthejnë huat e marra. Sipas të dhënave të AAB-së, në nëntor 2012, niveli i huave me probleme arriti në 23 për qind, duke shënuar një rritje prej 0.2 për qind kundrejt muajit të mëparshëm dhe një rritje prej 4.3 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Nga ana tjetër, konsumi në vend është tkurrur; të njëjtën prirje kanë ndjekur dhe investimet private si dhe dërgesat e emigrantëve. Konsumatorët dhe bizneset janë të pasigurt për të ardhmen dhe ky është mjedisi në të cilin po operojnë aktualisht bankat, jo për faj të tyre, por që në mënyrë të pashmangshme do të pasqyrohet në aktivitetin huadhënës. Kujdesi që ato po tregojnë në huadhënie, është i imponuar nga ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në vend. Në këto kushte, i takon sipërmarrjes që të paraqesë projekte të besueshme dhe të sigurta, me qëllim sigurimin e financimeve nga sistemi bankar. Në fund të fundit, bankat kanë interes kryesor huadhënien, veçanërisht në kushtet aktuale, kur niveli i depozitave është rritur. Sipas AAB-së, në nëntor 2012, pranë sistemit bankar ishin depozituar 993.8 miliardë lekë, me një rritje prej 76 miliardë lekë kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë. Këto shifra dëshmojnë se sistemi bankar ka likuiditet të mjaftueshëm për të dhënë hua, por i takon biznesit që të jetë një partner i besueshëm.

Deri më tani, bankat kanë qenë financuesi dominues i ekonomisë shqiptare dhe kontribuesi kyç në rritjen e fortë ekonomike të vendit, por ato vijojnë të jenë biznes si gjithë të tjerët dhe duhet të tregojnë kujdes për t'u mbrojtur nga çdo lloj ndikimi apo efekti negativ, që vjen nga klima e përgjithshme ekonomike në vend. Kjo dhe për faktin se bankat kanë përgjegjësi financiare, morale dhe publike ndaj të gjithë klientëve, që kanë depozituar kursimet e tyre në to. Rrjedhimisht, bankat duhet të sigurojnë fitim të mjaftueshëm, për të garantuar pagesat e interesave të depozitave të klientëve, mbulimin e huave me probleme dhe për të përmbushur pritshmërinë e aksionarëve. Në këto kushte, bankat nuk mund të tolerojnë financimin e projekteve që nuk janë të besueshme dhe cilësore. Prandaj është mëse e drejtë të pohohet se rënia e huadhënies nuk është thelbësisht për “faj” të bankave dhe rritjes së shkallës së tyre të kujdesit, por një zgjedhje e detyruar që imponohet nga ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në vend dhe kohët e vështira që po kalon biznesi. Të tregosh kujdes është një ndër mësimet e nxjerra nga kriza dhe kjo vlen veçanërisht për institucionet financiare, që menaxhojnë paratë tona.

DEPOZITA



☎ 04 22 34 096 @ [www.bankacredins.com](http://www.bankacredins.com)

# Në shtëpi, paratë tuaja nuk kanë vlerë.

## Eja përfito tani Interes dhe Siguri.

Lek  
deri në **7%**

Dollar  
deri në **2.5%**

Euro  
deri në **4%**



**CREDINS** bank

## "VENETO BANKA...shpaloset!"



**Z. Lucio GAITA**  
Drejtor i Përgjithshëm  
Veneto Banka

**BANKIERI:** BRENDA NJË PERIUdhË RELATIVISHT TË SHKURTËR KOHE, BANKA JU AJ KA HAPUR DISA DEGË TË REJA, NDËRKOHË KUR RRJETI I PËRGJITHSHËM BANKAR KA NJË ZGJERIM TEPËR TË KUFIZUAR. CILA ËSHTË ARSYEJA PRAPA NJË LËVIZJE TË TILLË?

Veneto Banka është një bankë relativisht e re në sistemin bankar shqiptar, e blerë vetëm në vitin 2009 nga Grupi Veneto Banka, me qendër në Trevizo të Italisë. Një nga qëllimet kryesore të këtij grupi mjaft dinamik në Itali, është shtrirja në territore të reja me banka të konsoliduara. Ndoshta kjo mund të jetë pak e guximshme në këtë moment, kur ndihen efektet e krizës si kudo, e kur bankat e tjera, sipas opinionit tim, janë në momente reflektimi. Këtu bazohet dhe strategjia jonë, ku theksi vendoset mbi shfrytëzimin e kapaciteteve tregtare, kryesisht në përzgjedhjen e klientelës. Konkretisht, synohet një potencial zhvillimi i gërshetuar me zgjerimin e veprimtarisë në treg, kryesisht duke hapur filiale të reja në territore "të pa-mbuluara". Kjo, falë dhe përzgjedhjes me kujdes se ku ato do të operojnë, sipas një procesi gërshetimi të vlerave dedikuar shërbimit të klientëve dhe stafit të përkushtuar e mjaft profesional.

**BANKIERI:** SI PJESË E NJË PREJ GRUPEVE BANKARE MË TË MËDHA NË ITALI, MUND TË SHPJEGONI SHKURTIMISHT STRATEGJINË E BIZNESIT PËR TË ZGJERUAR VEPRIMTARINË BANKARE NË SHQIPËRI?

Grupi Veneto Banka është prezent prej vitesh në vendet e Europës Juglindore, duke kontrolluar kapitalin e disa bankave në: Rumani (Banca Italo Romena), Moldavi (Eximbanka) dhe Kroaci (Veneto Banka). Banka i shërben klientëve tanë jashtë territorit italian, me një numër të madh filialesh,

ADN-ja e të gjitha bankave të Grupit Veneto Banka, kudo ku grupi vepron tradicionalisht prej vitesh me bankat e saj, është marrëdhënia e drejtpërdrejtë, duke iu ofruar klientëve shërbime bankare cilësore

pasi Grupi Veneto Banka është grupi i tretë bankar italian me më shumë filiale jashtë Italisë. Mjaft biznese të vogla e të mesme italiane operojnë prej kohësh në Europën Juglindore, dhe shumë prej tyre janë mjaft aktive, me investime strategjike. Këto biznese kanë përzgjedhur bankat e Grupit Veneto Banka si partnere në zhvillimin e tyre në këto territore; për më tepër në Shqipëri, ku aktualisht Italia është partneri kryesor tregtar me afërsisht 45% të totalit të shkëmbimeve tregtare. Nisur nga kjo, Grupi Veneto Banka evidentoi Shqipërinë si treg potencial zhvillimi të biznesit italo-shqiptar, që për hir të së vërtetës, po shënon çdo vit stabilitet në shkëmbimet tregtare. Mendoj se ky treg ka shumë potenciale zhvillimi e rritje në të ardhmen në disa sektorë strategjikë, të cilët do të kenë ndryshime pozitive në Shqipëri, të krahasueshme me vendet e tjera në rajon. Këtu mund të përmendim investimet në sektorin e turizmit, burimet natyrore, energjinë, infrastrukturën etj.

**BANKIERI:** ÇFARË E DALLON NË SYTË E KONSUMATORIT SHQIPTAR?

Veneto Banka, si gjithë bankat që janë pjesë e Grupit Veneto Banka, ka në profilin e saj marrëdhënien e drejtpërdrejtë me klientin, duke iu dedikuar atij me të gjitha mundësitë e saj menaxhuese. Shërbimet e Veneto Banka janë në çdo kohë cilësore dhe në kohë reale. Dinamizmi i deritashëm, i gërshetuar me profesionalizmin e stafit të Veneto Banka, ka dhënë frytet e tij. Sot gjendemi përballë një realiteti të patjetërsueshëm aspak të rastësishëm, ku Veneto Banka, falë dedikimit dhe shërbimit 360 gradë në shërbim të klientëve, ajo ka shënuar hapa mjaft cilësorë zhvillimi dhe pozicionimi në një treg vital bankar si ai shqiptar. ADN-ja e të gjitha bankave të Grupit Veneto Banka, kudo ku grupi vepron tradicionalisht prej vitesh me bankat e saj, është marrëdhënia e drejtpërdrejtë, duke iu ofruar shërbime bankare cilësore klientëve.

**BANKIERI:** SI E SHIHNI JU POZICIONIMIN E VENETO BANKA NË SEKTORIN BANKAR SHQIPTAR DHE NË SISTEMIN FINANCIAR?

Është i rëndësishëm të evidentohet fakti që Veneto Banka nuk mund të krahasohet me bankat e tjera më të mëdha, që operojnë prej vitesh në sistemin bankar shqiptar, si dhe me shtrirjen e tyre me një numër të konsiderueshëm filialesh, thuajse në çdo qytet të Shqipërisë. Gjithsesi, nisur nga eksperiencat e ndryshme në të tetë qytetet ku ne operojmë me filiale tona në Shqipëri, mendoj se gjithçka duket pozitive. Sigurisht, ka një rritje mjaft të dukshme, e pasqyruar kjo dhe në raportet e AAB-së. Ajo që do doja unë të konfirmoja si drejtor i Përgjithshëm i Veneto Banka, është se strategjia jonë do të jetë ajo e mbajtjes së po të njëjtës ecuri.

## RREZIKU OPERACIONAL: NJË RREZIK I NDËRLIKUAR QË DUHET MENAXHUAR ME KUJDES



**nga Erinda DOÇI**

*Përgjegjëse e Sektorit të Riskut Operacional dhe Mashtrimit të Kredisë Departamenti i Riskut të Integruar dhe Menaxhimit të Portofolit Raiffeisen Bank*

Rreziku operacional është një koncept relativisht i ri, i lakuar dhe i diskutuar më shumë në dhjetëvjeçarin e fundit, kur kultura e menaxhimit të rrezikut është zgjeruar përtej koncepteve tradicionale të perceptimit dhe menaxhimit vetëm të rrezikut financiar, të besueshmërisë, të tregut etj.

Çdo sipërmarrje e bazon veprimtarinë e saj mbi punën e njerëzve, e cila organizohet nëpërmjet proceseve dhe procedurave specifike, që nga ana tjetër po mbështeten gjithnjë e më shumë në sisteme apo platforma teknologjike. Dështimi i njërit prej këtyre elementëve për shkak të jashtëme apo të brendshme, mund t'i shkaktojë humbje financiare sipërmarrjes; ky është ai që përkufizohet si rrezik operacional – një rrezik sistematik që bashkëjeton më çdo lloj forme të të bërit biznes, fitimprurës apo jo, privat apo publik, lokal apo ndërkombëtar.

Rreziku operacional është një rrezik shumëpërmasor dhe ato ndryshojnë nga një industri në tjetrën. Si figura

Sfida më e madhe për bankat shqiptare, më shumë se hartimi i politikave dhe procedurave për menaxhimin e rrezikut operacional, është shndërrimi i koncepteve të rrezikut operacional në kulturë të përditshme pune.

të tilla rreziku mund të përmenden:

- Llogaritja e një shume transaksioni gabim, duke i shtuar një zero gabimisht;
- Mosraportimi në kohë të autoritetet publike apo mbikëqyrëse;
- Nxjerrja e informacionit konfidencial;
- Pushimi nga puna i një punonjësi për shkak të origjinës etnike apo bindjeve fetare;
- Falsifikimi i dokumenteve apo firmave që kërkohen për realizimin e një transaksioni;

Identifikimi i saktë i rrezikut operacional kërkon njohuri të gjera mbi të gjitha proceset kryesore të punës, mbi mënyrën se si janë ndërtuar e rregulluar me procedura, si dhe njohuri shumë të mira teorike dhe praktike për të gjitha tipet e rreziqeve operacionale.

- Përhapja e një virusi në sistemin kompjuterik;
- Dëmet e shkaktuara nga tërmeti.

Në sektorin bankar, rreziku operacional renditet sot në krah të rreziqeve të rëndësishme që një bankë duhet të menaxhojë për të minimizuar humbjet, si p.sh.: rreziku i besueshmërisë, rreziku i likuiditetit, rreziku i kursit të këmbimit etj. Identifikimi dhe matja e rrezikut operacional është një çështje e hapur dhe ka marrë vëmendje të veçantë, që kur Komiteti i Mbikëqyrjes Bankare të Baselit vendosi që një pjesë e kapitalit të bankave të alokuar për humbjet, mund të shkaktohen nga rreziku operacional (sipas Marrëveshjes së së Bazelit II, të vitit 2004). Kuadri rregullator i këtij Komiteti ofron tri mënyra kryesore për përllogaritjen e këtij kapitali, nga më e thjeshta, si përqindje fikse mbi të ardhurat e shoqërisë, e deri te më e avancuara, që bazohet në modelime të brendshme statistikore të humbjeve historike nga rreziku operacional. Sa më të avancuara të jenë praktikatat e menaxhimit të rrezikut operacional, aq më e avancuar dhe e saktë është mënyra e përllogaritjes së kapitalit që duhet alokuar për këtë rrezik. Bazeli II ka përcaktuar tetë lloje kryesore të rrezikut operacional:

1. Mashtrim i jashtëm, që ka të bëjë me keqpërdorimin e aktiveve të shoqërisë nga klientë, palë të treta apo kontraktorë me qëllime përfitimti;
2. Mashtrim i brendshëm, që ka të bëjë me keqpërdorimin e aktiveve

të shoqërisë nga punonjës të bren-  
dshëm me ose pa bashkëpunimin  
e palëve të jashtme;

3. Praktika të punësimit dhe siguri-  
së në punë, në të cilën klasifiko-  
hen ngjarjet që lidhen me proceset  
e punësimit, sigurisë së mjediseve  
të punës, si dhe diversitetit/dis-  
kriminimit të punonjësve;
4. Praktika për klientët, produktet  
dhe biznesin, që ka të bëjë me  
mospërbushje të detyrimeve  
kontraktuale, ligjore dhe profesio-  
nale kundrejt klientëve, si pasojë  
e veprimeve të paqëllimshme, ne-  
glizhencës apo nga natyra e pro-  
dukteve të ofruara;
5. Dëmtim i qëllimshëm, ku kla-  
sifikohen të gjitha veprimet me  
karakter dëmtues për shoqërinë,  
që nuk bëhen për përfitime të  
drejtpërdrejta financiare për atë  
që i kryen, si për shembull: akte  
vandalizmi, terrorizmi, infektimi  
me viruse kompjuterike etj.;
6. Siguria publike dhe katastrofat  
natyrore, ku klasifikohen ngjarjet  
madhore, si: tërmetet, përmytjet  
dhe ngjarjet që shkaktohen nga  
mungesa e elementëve të sigurisë  
në mjediset e ofrimit të shërbime-  
ve;
7. Dështimi i teknologjisë dhe infra-  
strukturave, ku klasifikohet çdo  
lloj dështimi i infrastrukturave  
që mbështesin biznesin, si: pro-  
gramet kompjuterike, pajisjet har-  
dware, linjat e komunikimit, rrjeti  
elektrik etj.;
8. Ekzekutimi, shpërndarja dhe me-  
naxhimi i proceseve, ku klasifiko-  
hen të gjitha ekzekutimet e gabu-  
ara apo mosekzekutimet e tran-  
saksioneve, si pasojë e gabimeve  
njerëzore, mungesës së raportimit  
apo menaxhimit të të dhënave.

Identifikimi i saktë i rrezikut opera-  
cional kërkon njohuri të gjera mbi  
të gjitha proceset kryesore të punës,  
mbi mënyrën se si janë ndërtuar e  
rregulluar me procedura, si integro-  
het elementi njerëzor, si përfaqet  
klienti, si janë të ndërtuara linjat e  
komunikimit, cilët janë sistemet apo  
aplikacionet teknike që mbështesin të  
gjithë aktivitetin e biznesit dhe si janë  
përcaktuar të drejtat e përdoruesve  
në këto sisteme. Gjithashtu, kërkohen  
njohuri shumë të mira teorike dhe  
praktike për të gjitha llojet e rreziqe-  
ve operationale (të përshkruara më  
sipër). Kombinimi i çdo procesi pune  
me çdo lloj rreziku operacional duhet  
vlerësuar me një shkallë rreziku që i

Në sektorin bankar,  
rreziku operacional  
renditet sot në  
krah të rreziqeve  
të rëndësishme që  
një bankë duhet të  
menaxhojë për të  
minimizuar humbjet,  
si p.sh.: rreziku i  
besueshmërisë,  
rreziku i likuiditetit,  
rreziku i kursit të  
këmbimit etj.

korrespondon humbjes financiare që  
mund të shkaktohet nga ky proces.  
Treguesit e rrezikut janë mjete tipi-  
ke për monitorimin e vazhdueshëm  
të rrezikut operacional në ato zona  
të bankës, ku mundësia për inciden-  
te operationale është më e madhe.  
Këta tregues janë përgjithësisht tre-  
gues statistikorë ose financiarë, që  
duhen ndërtuar sipas nevojave të  
procesit që monitorohet, që duhet  
të maten periodikisht dhe duhet të  
krahasohen kundrejt vlerave fikse që  
përcaktojnë shkallën e pranueshme  
të rrezikut. Shembuj të tillë janë: an-  
kesat e klientëve, diferencat e arkës,  
mashtimet e brendshme, transak-  
sione të procesuara gabim nga sta-  
fi, ndërprerje të sistemeve teknike

kyçe të bankës, qarkullimi i stafit etj.  
Banka gjithashtu duhet të regjistrojë  
çdo humbje financiare që shkakto-  
het nga incidentet operationale, me  
qëllim jo vetëm marrjen e masave  
për të zvogëluar humbjen, por edhe  
për të marrë masa parandaluese që  
të tjerë incidente të ngjashme të mos  
përsëriten në të ardhmen; mbledhja  
e të dhënave të tilla është gjithashtu  
e nevojshme për të ndërtuar modele  
të brendshme vetë-vlerësimi rreziku,  
çka do t'i krijojë mundësinë bankës të  
kalojë më shpejt në mënyrën e avan-  
cuar të përlogaritjes së kapitalit për  
rrezikun operacional.

Në sektorin financiar dhe bankar  
shqiptar, rreziku operacional është  
koncept relativisht i ri. Banka e  
Shqipërisë ka publikuar më 2011  
rregulloren e parë mbi menaxhi-  
min e rrezikut operacional, që është  
e detyrueshme për zbatim nga të  
gjitha bankat e nivelit të dytë dhe  
institucionet e ngjashme financia-  
re. Megjithatë sfida më e madhe për  
bankat shqiptare, më shumë se har-  
timi i politikave dhe procedurave  
për menaxhimin e rrezikut operaci-  
onal, është shndërrimi i koncepteve  
të rrezikut operacional në kulturë  
të përditshme pune. çdo menaxher  
apo supervisor, pavarësisht nëse i  
përket fushës së shitjes, marketin-  
gut, financës, rrezikut, operationeve  
apo IT, duhet të menaxhojë përpos të  
tjerave edhe rrezikun operacional në  
fushën përkatëse; kjo është e vetmja  
mënyrë e suksesshme që mund të  
garantojë identifikimin, vlerësimin,  
monitorimin dhe kontrollin optimal  
të rrezikut operacional.



OFERTAT MË TË MIRA DHE KONKURUESE  
NË TREGUN BANKAR!



CBA JU OFRON:

Depozita, llogari rrjedhëse dhe me afat, tranferta parash, garanci bankare,  
shkembime dhe te gjitha sherbimet tradicionale bankare

Adresa: Rr. "Perlat Rexhepi",  
Ndërtesa Administrative "AL-KHARAFI" (prane Fakultetit  
Juridik), Tiranë, Shqipëri  
Tel: +355 4 2 272168/66; Fax: + 355 4 2 272162  
E-mail: creditbkalb@icc-al.org  
creditcba@icc-al.org

SheratonTirana Hotel  
Shopping Plaza  
Tel: +355 4 2 2255372/388/368/346  
Fax: +355 4 2 255340

Hotel "Butrinti", Sarandë  
Tel: +355 85 2254 05



## SFIDA E INFORMIMIT TË INDIVIDËVE PËR HUA NGA BANKAT NË SHQIPËRI



**nga Gentiana DUKA, MSc**  
Supervizore e Seksionit të Huave  
Personale & Konsumatore  
Alpha Bank

Vite më parë, marrja e një huaje për individë në Shqipëri, ishte diçka e ndërlikuar madje deri në kufijtë e pamundësisë. Me kalimin e viteve, diçka e tillë, filloi të bëhej gjithnjë e më zakonshme dhe më e arritshme. Në ato vite, edhe vetë klientët kishin njohuri tejet modeste se si kryhej shlyerja apo ripagimi i huas dhe si mund të bëheshin të vetat fondet që ata kërkonin nga banka, vetëm duke dorëzuar disa dokumente personale.

Në momentin aktual, nëse dikush ka nevojë për një hua konsumatore, hua për shtëpi apo hua për arsye e qëllime të tjera, ai/ajo mjafton t'i drejtohet shërbimit të klientelës, pranë njërës nga 16 bankat tregtare, që operojnë në Shqipëri. Atje, gjithkush mund të shfaqë interesin për huan që ka nevojë të marrë, si dhe të fillojë procedurën përkatëse. Sigurisht, duhet pranuar që ecuria e veprimtarisë dhe shërbimi i degëve përkatëse të bankave në Shqipëri, është për t'u lavdëruar dhe mund të pohohet se zhvillimi i sistemit bankar ka ecur me hapa relativisht të shpejtë, për t'ju përshtatur nivelit të bankave dhe shërbimit në rajon.

Bankat tashmë kanë të bëjnë me “klientë të edukuar” e të informuar për veprimtarinë financiare dhe “alternativën më fitimprurëse” për ta, ndaj lind nevoja për qasje të reja të informimit të publikut.

Por sa e kanë informacionin e nevojshëm qytetarët shqiptarë për hapat që duhen ndjekur dhe procedurën përkatëse të funksionimit të procesit të huadhënies? Mund të pranohet që shumë individë, klientë të mundshëm huamarrës të bankave, ndoshta nuk kanë informacion për një pjesë të konsiderueshme të procesit të huadhënies. Faktikisht, në një analizë më të detajuar, mund të theksohet se ky informacion, lidhur me procesin që ndjek huaja është më tepër specifik për personat që punojnë në sektorin bankar, apo në sektorë të ngjashëm. Ajo që vlen të theksohet, e që është më se e dukshme, është fakti që një

pjesë e mirë e qytetarëve shqiptarë nuk janë më ata qytetarë të disa viteve më parë, për sa i përket informacionit që kanë mbi dhe për sektorin bankar. Në ditët e sotme ata kanë një informacion më të plotë për llojet e huave, madje dhe për elementët e një huaje dhe kushtet që duhet të plotësohen, për të arritur marrjen e shumës së kërkuar të huas së disbursuar në llogarinë e tij të huas. Ky fakt është domethënës dhe për vetë bankat tregtare, apo dhe institucionet financiare që operojnë në Shqipëri, që tashmë kanë të bëjnë me “klientë të edukuar” dhe klientë të informuar për veprimtarinë financiare dhe “alternativën më fitimprurëse” për ta, duke arritur të bëjnë dhe llogaritje apo krahasime të detajeve të produkteve bankare.

Thuajse të gjitha bankat tregtare që operojnë në Shqipëri, kanë vënë në dispozicion të klientëve të tyre forma të ndryshme informimi, qoftë edhe nëpërmjet “Bankingut Alternativ”.

Tregu bankar në Shqipëri tani ka shumë ndryshim me një dhjetëvjeçar më parë, ku vetëm për të marrë informacion paraprak çdo individ ishte i detyruar të paraqitej në sportelin e bankës, e më pas të paraqitej përsëri disa herë radhazi, për çdo informacion shtesë si dhe për të aplikuar për hua.

Tregu bankar në Shqipëri tani ka shumë ndryshim me një dhjetëvjeçar më parë, ku vetëm për të marrë informacion paraprak çdo individ ishte i detyruar të paraqitej në sportelin e bankës, e më pas të paraqitej përsëri disa herë radhazi për çdo informacion shtesë, si dhe për të aplikuar për hua. Sot individët mund të marrin informacion nga faqet e internetit të bankave, nga fletëpalosjet që i referohen çdo produkti përkatës, apo dhe nëpërmjet formave të tjera të informimit. Gjithsesi, klientët janë ende jo shumë të familiarizuar me kërkesën për të sjellë dhe dorëzuar në bankë disa dokumente, që janë të nevojsh-

Formë tjetër e suksesshme e zbatuar nga bankat e rajonit është dhe mundësia e aplikimit për hua nga faqet e internetit të secilës bankë në kohë reale, sipas kushteve përkatëse të huas, e më pas klienti paraqitet në bankë vetëm për të dorëzuar dokumentet e nevojshme për aprovimin e saj.

me për të përfitur huanë dhe për të vijuar marrëdhënien me bankën. Një fakt i tillë është disi i vështirë për t'u kuptuar nga klientët standardë.

Gjithashtu, një tjetër fakt pozitiv në këtë drejtim, e që ndikon drejtpërdrejt në informimin e klientëve për produktet bankare janë dhe vendimet e Bankës së Shqipërisë, të marsit të vitit 2012.

Konkretisht, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi përkatësisht disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren: "Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekore për individët" dhe në rregulloren: "Mbi

transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare". Këto ndryshime sollën një ndikim të menjëhershëm në plotësimin dhe dhënien e informacionit nga bankat tregtare dhe institucionet financiare për klientët e tyre, e në të njëjtën kohë pasurimin me informacion të faqeve të internetit, fletëpalosjeve dhe çdo lloj alternative tjetër informacioni, në funksion të sigurimit të një transparence optimale për klientin.

Një tjetër formë transparente informacioni ishte edhe Forma parakontraktore për kreditë për individë, e përfshirë kjo brenda rregulloreve të reja të Bankës së Shqipërisë, si një informacion i detyrueshëm për t'ju paraqitur klientit në degët e çdo banke, në momentin e aplikimit për një hua konsumatore, hua për shtëpi apo të çfarëdo lloj huaje tjetër për individë. Kjo formë parakontraktore përmban të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me produktet bankare, që nga momenti i dorëzimit të dokumenteve përkatëse e deri te komisionet përkatëse, apo mënyra e shlyerjes së huas. Sigurisht që ditët e sotme klientët janë më të informuar, të favorizuar dukshëm dhe nga teknologjia, që mundëson servirjen e informacionit në forma të shumëllojshme, duke qenë se edhe produktet bankare sa vijnë dhe bëhen më fleksibël në tregun bankar shqiptar.

Gjithsesi, mund të thuhet se ende ka vend për përmirësim, pavarësisht se bankingu shqiptar ka ecur me hapa të admirueshëm, për të qenë sot në një nivel të pranueshëm e plotësisht të krahasueshëm me institucionet

bankare të rajonit të Ballkanit. Kështu, në faqet e internetit të bankave shqiptare mund të shihet mundësia e ofrimit të konsultimit apo shërbimit online ("Online Chat"), në përgjigjen e pyetjeve të klientëve, proces ky shumë i përhapur në vendet e tjera. Kjo mënyrë komunikimi i afron klientit më shumë me bankën, pa qenë nevoja të shkëputen disa herë nga punët dhe angazhimet e përditshme, për të ardhur në sportelin e bankës. Një tjetër risi në tregun bankar shqiptar, e që në mënyrë të padiskutueshme ka filluar të ketë një ndikim pozitiv, është vendosja llogaritësit të këstit të huave (kjo gjykohet të jetë e pranishme në të gjitha faqet e bankave shqiptare dhe jo vetëm në disa prej tyre). Ky fakt ndihmon shumë klientin në informimin paraprak dhe ballafaqimin e të ardhurave të tij me detyrimet e ardhshme si dhe me mënyrën e amortizimit të huas. Formë tjetër e suksesshme, e zbatuar nga bankat e rajonit, është dhe mundësia e aplikimit për hua nga faqet e internetit të secilës bankë në kohë reale, sipas kushteve përkatëse të huas, e më pas klienti paraqitet në bankë vetëm për të dorëzuar dokumentet e nevojshme për aprovimin e saj.

Edhe pse mbetet akoma vend për përmirësim në tregun bankar shqiptar është pozitiv fakti, që bankat tregtare çdo ditë e më shumë përpiqen maksimalisht të trajtojnë me profesionalizëm çdo veprimtari financiare dhe operacionale, si dhe përpiqen të përmirësojnë ecurinë dhe shërbimet e tyre, duke u bërë sa më konkurruese në treg.



# NDËRTIMI I NORMAVE TË INTERESIT PËR HUAT BANKARE



**nga Dr. Spiro BRUMBULLI**  
Rektor  
Tirana Business University, TBU

Opinion i publik diskuton shpesh mbi normat e interesit. A janë normat e interesit të huas të larta? A shprehin normat e interesit ekuilibrin e kërkesës dhe ofertës në treg? A e rëndojnë apo lehtësojnë ato ekonominë? Përpara se ta konkretizojmë me një shembull të thjeshtuar mënyrën e llogaritjes dhe ndërtimit të normës së interesit për huat e një banke tregtare, (duke u kërkuar ndjesë bankierëve për abstragimin e shumë faktorëve që ata ndeshin realisht dhe sepse nuk do të analizohet vlerësimi i kostos së depozitave), le të shikojmë shkurtimisht katër metodat kryesore të llogaritjes së normave të interesit.

Le të shikojmë fillimisht metodën e llogaritjes së normës së interesit për huat (supozohet që mjetet që sjellin interes janë vetëm huat), sipas *modelit të vlerësimit mbi bazën e kostove*. Supozojmë së një bankë ka 10 miliardë lekë kapital dhe 90 miliardë lekë depozita, pra detyrimet dhe kapitali i vet janë 100 miliardë lekë. Këto burime janë përdorur për hua (mjete që fitojnë interes) në masën 80 miliardë lekë dhe 20 miliardë lekë janë mjete që nuk fitojnë interes. Banka për depozitat paguan mesatarisht një normë interesi

Cilido qoftë niveli i normës së interesit për huat, gjithnjë do të ketë kërkesa të rrezuara, pasi gjithnjë do të ketë projekte që rezultojnë pa justifikim ekonomik, ashtu siç do të ketë individë që do të refuzohen për shkak të mosplotësimit të kërkesave kualifikuese

prej 4%; shpenzimet administrative dhe ato të veprimtarisë llogariten në 2.2 miliardë lekë dhe provizionet për humbjet nga huat llogariten në 0.4 miliardë lekë.

Llogaritur në shifra absolute, këto shpenzime do të ishin:

1. Shpenzime për interesat: 3.6 miliardë lekë ( $90 \times 0.04$ )
2. Shpenzime për veprimtarinë: 2.2 miliardë lekë
3. Provizione për huat: 0.4 miliardë lekë

Nga ana tjetër, norma e kërkuar e kthimit e aksionarëve për kapitalin e investuar është 20%; të ardhurat jo nga interesi (komisionet) llogariten në 0.5 miliardë lekë. Në këto kushte, sa duhet të jetë norma e interesit që banka duhet të caktojë për huat, që të plotësohen të gjitha kërkesat e mësipërme?

Në kushtet e shembullit tonë, norma e interesit duhet të konsiderojë:

- a) koston e fondeve të grumbulluara: 3.6 miliardë lekë;
- b) shpenzimet e veprimtarisë: 2.2 miliardë lekë;

- c) rrezikun e dhënies së huave: 0.4 miliardë lekë;
- d) normën e kërkuar të kthimit të aksionarëve:

2 miliardë lekë ( $0.2 \times 10$ ).

Janë gjithsej 8.2 miliardë lekë që duhen mbuluar nga të ardhurat e veprimtarisë së bankës. Duke zbritur 0.5 miliardë lekë të ardhurat nga komisionet, mbeten 7.7 miliardë lekë që duhen siguruar nga mjetet që fitojnë interes. Pra:  $7.7/80 = 9.63\%$ . Rrjedhimisht, norma e interesit që duhet vendosur për huat është 9.63%.

Përmbledhtazi, nga shembulli i mësipërm rezulton se norma e interesit duhet:

1. të mbulojë kostot për interesat e grumbullimit të fondeve. Sa më të lira fondet e mbledhura, aq më shumë mundësi ka për uljen e normës së interesit të caktuar te mjetet që sjellin interes.
2. të mbulojë koston e veprimtarisë së bankës (shpenzimet administrative dhe shpenzimet operative). Rishikimi i shpenzimeve mbi bazën e analizës së detajuar

## NORMA E INTERESIT DUHET:

- të mbulojë kostot për interesat e grumbullimit të fondeve,
- të mbulojë koston e veprimtarisë së bankës,
- të marrë parasysh rrezikun për dhënien e huave,
- të konsiderojë dhe normën e kërkuar të kthimit të aksionarëve



# Eksperiencia jonë përfitimi juaj



[www.credit-agricole.al](http://www.credit-agricole.al)

Grupi Crédit Agricole është lider për Retail në Francë dhe një nga grupet bankare më të mëdha në Europë. Crédit Agricole synon t'i shërbejë ekonomisë duke mbështetur klientët në projektet e të gjitha fushave të retail banking dhe linjave të specializuara të biznesit.

Duke vënë në pah vlerat dhe angazhimin e tij, Crédit Agricole Group është banka e praktikishtit. Ajo ve në zemër të aktivitetit të saj interesin e 54 milion klientëve, 160,000 miqe punonjëse, 1.2 milion aksionerëve dhe 6.5 milion aksionerëve të përbashkët.

 **CRÉDIT  
AGRICOLE**

përbën një rezervë për uljen e kostos, që ndikon në uljen e normës së përgjithshme të interesit të caktuar për huat.

3. të marrë parasysh rrezikun për dhënien e huave. Kjo shtesë e normës së interesit kompenson bankën nga rreziku i dështimit që shoqëron kërkesën për hua. Ky rrezik mund të llogaritet si provizion i përgjithshëm kundrejt standardeve të vendosura nga Banka e Shqipërisë dhe të kërkua nga standardet ndërkombëtare të kontabilitetit. Në kushtet kur ky rrezik është i ulët, atëherë dhe efekti i tij është në të njëjtin kah të norma e përgjithshme e interesit të caktuar për huan.
4. të konsiderojë dhe normën e kërkuar të kthimit të aksionarëve. Asnjë investues nuk investon paratë e tij në një biznes, nëse ai biznes nuk i kthen një normë që të justifikojë rrezikun e ndërmarrë.

Përveç modelit të vlerësimit mbi bazën e kostove, ekzistojnë dhe tri modele të tjera për përcaktimin e normës së interesit për huat.

*Modeli i normës bazë.* Ky model është i rëndësishëm, pasi merr në konsideratë konkurrencën. Në një mjedis konkurrues, llogaritja e normës së interesit, sipas modelit të vlerësimit mbi bazën e kostove mund të jetë e saktë, por jashtë tregut. Për pasojë, banka duhet të bëjë llogaritjet duke konsideruar tregun. Në këtë rast, përdorimi i normës bazë i sjell ndryshimet midis bankave brenda një rrethi më të vogël dhe më pranë tregut. Norma bazë mund të jetë një nga indekset e përdorur si normë kryesore (referencë) në monedhën përkatëse (p.sh.: TRIBOR ose bono thesari për lekun, EURIBOR për euro-n, LIBOR për dollarin). Mbi normën bazë shtohet marzhi i kërkuar nga banka. Kjo normë përdoret në të gjitha rastet kur huat ofrohen me normë interesi të ndryshueshme.

*Modeli i bazuar në sistemin e vlerësimit të besueshmërisë.* Ky model synon të vlerësojë borxhmarrësit bazuar në karakteristikat e tyre individuale të besueshmërisë. Sipas këtij modeli, borxhmarrësit me nivel të ulët të rrezikut nuk mund të subvencionojnë koston e borxhmarrësve me nivel të lartë të rrezikut. Këtë kategorizim dhe ndarje e realizon sistemi i përdorur për vlerësimin e besueshmërisë, që qëndron në bazë të këtij modeli, e që përdoret si mjet për vendosjen e shtesës mbi normën bazë.

*Modeli i faktorëve të tjerë bazuar në rrezik.* Sipas këtij modeli, dy faktorët e tjerë që ndikojnë në madhësinë e shtesës së normës së interesit mbi normën bazë janë garancia shtesë dhe kohëzgjatja e huas. Sa më e mirë dhe likuide garancia shtesë, aq më e ulët norma e interesit (p.sh.: një normë interesi e një huaje për shtëpi është më e ulët se një hua e siguruar me peng dhe shumë më e ulët se një normë interesi për huat e pasiguruara). Sa më e shkurtër kohëzgjatja e huas, aq më pak mundësi ka të ndryshojë mjedisi i borxhmarrësit e, për pasojë, edhe norma e interesit do të jetë më e ulët dhe anasjelltas.

Atëherë, a janë të larta normat e interesit për huat? Kjo pyetje nuk ka një përgjigje të vetme, pasi nëse do të themi "e lartë", kundërpjetja është "e lartë në krahasim me kë?" Nëse një normë interesi prej 11% tingëllon e lartë në madhësi absolute (p.sh.: 11% > 7%), ky nuk është me patjetër një argument në favor të shtrenjtësisë së huas, pasi mundet që inflacioni të jetë 6% dhe norma reale e interesit të rezultojë e ulët. Gjithashtu, nëse flasim për normat e interesit në Lek, ato janë unike, pasi Leku është monedhë unike dhe kosto e tij buron nga faktorë të ekonomisë vendase. Nëse flasim për monedha të huaja, krahasimi me normat e interesit ku ajo monedhë është vendase, është prapë pa një përgjigje të vetme, pasi ndikimi i kursit të këmbimit dhe kushteve ekonomike, që përcaktojnë normat e interesit në secilin vend, janë të ndryshme. Por a duhet pranuar çdo kosto e ofruar nga banka? Kjo pyetje e ka një përgjigje: çdo biznes, siç bën banka analizat e veta, duhet të bëjë analiza, nëse huaja me koston e ofruar arrin të prodhojë fitim, për t'i mbuluar këto kosto apo jo. Nëse projekti është i pranueshëm, relativiteti i madhësisë së normës së interesit të huas humbet; nëse projekti nuk rezulton ekonomik, atëherë norma e kthimit nga ai projekt është më e vogël se norma e interesit të huas. E njëjta logjikë funksionon dhe për individin: nëse me të ardhurat që siguron mund të ripaguajë huan, atëherë nevoja e tij për parë hua plotësohet; në të kundërt, nuk kualifikohet për hua. Por, nëse situata dhe analiza e paraqitur në planin e biznesit nuk paraqet të vërtetën, atëherë asimetria e informacionit me shumë gjasa do e kthejë huan në hua të keqe, për shkak të moskonsiderimit nga banka të të gjithë faktorëve, në momentin e dhënies së huas. Ma-

dhësia e normës së interesit për huat është relative dhe në një aspekt tjetër. Çfarëdo që të jetë niveli i normës së interesit për huat, gjithnjë do të ketë kërkesa të rrëzuara, pasi gjithnjë do të ketë projekte që rezultojnë pa justifikim ekonomik, ashtu siç do të ketë individë që do të refuzohen për shkak të mosplotësimin të kërkesave kualifikuese. Duke vepruar me këtë parim të përzgjedhjes së projekteve dhe individëve me më pak rrezik, bankat luajnë rolin e ruajtjes dhe fuqizimit të eficiencës së ekonomisë, duke financuar projekte që janë ekonomikisht të pranueshme.

Një interpretim tjetër për relativitetin e madhësisë së normës së interesit mund të bëhet duke u nisur nga krahasimi i normës së kërkuar të kthimit dhe koston së kapitalit hua. Projektet, ose kërkesat për hua që nuk justifikohen ekonomikisht, pra ku norma e kërkuar e kthimit është më e ulët se kosto e kapitalit, nuk do të pranohen. Kjo do të thotë që bizneset duhet t'i kushtojnë më shumë rëndësi madhësisë së normës së kthimit që realizohet në projektet dhe veprimtarinë e tyre ekonomike. Nëse norma e kthimit do të jetë konsiderueshëm e lartë, atëherë venitet çështja e madhësisë së normës së interesit. Në fund të fundit, edhe bankat janë vetë biznes dhe kanë objektivin e tyre për normën e kërkuar të kthimit mbi kapitalin.

Bizneset duhet t'i kushtojnë më shumë rëndësi madhësisë së normës së kthimit që realizohet në projektet dhe veprimtarinë e tyre ekonomike, pasi nëse norma e kthimit do të jetë konsiderueshëm e lartë, atëherë venitet çështja e madhësisë së normës së interesit.

## KOMUNIKIMI DHE RËNDËSIA E TIJ NË SEKTORIN BANKAR



**nga Frida KRIFCA**  
Drejtoresh Marketingu dhe PR  
Tirana Bank

Struktura e sistemit bankar në Shqipëri deri në vitin 1991 pasqyrore një ekonomi tipike të centralizuar që kishte në përbërje: Bankën e Shtetit Shqiptar, Bankën e Kursimeve, Bankën Bujqësore e të Zhvillimit, si dhe Bankën Shqiptare të Tregtisë. Sistemi bankar dynivelësh, i krijuar në prill të 1992-shit, krijoi mundësinë për funksionimin e sistemit bankar, sipas modeleve perëndimore, ku bankat tregtare mund të mbledhnin depozita dhe jepnin hua për individë dhe biznese.

Ky ndryshim solli nevojën për të komunikuar, e në të njëjtën kohë, për të edukuar konsumatorët rreth asaj se çfarë janë produktet e shërbimet bankare dhe si mund të përdoren ato. Për sa i përket komunikimit, sigurisht që nevojitet kohë për të kuptuar ndryshimin e modelit të tij nga ana bankave shtetërore që po privatizoheshin, ndërkohë që bankat private treguan një qasje më agresive dhe fleksibël, e rrjedhimisht kishin mundësi të fitonin më shpejt pjesën e tregut. Gjithnjë e më shumë bankat përqipen dhe ende përqendrohen në zhvillimin e atij imazhi që "bën për vete" ndjenjat. Në një treg si Shqipëria, ku kontakti dhe ndërveprimi personal është kritik, imazhi i një marke (brand-i) ar-

Kombinimi i suksesshëm i asaj çka komunikohet me atë se ku komunikohet, si dhe me adresimin drejt audiencës së duhur, mund të jetë burimi për të krijuar përparësi konkurruese për bankën


rin të tërheqë klientët dhe së bashku përbëjnë arsye themelore pse krijojnë marrëdhënie të veçanta midis një klienti dhe imazhit të një banke si brand. Sa më gjatë zgjat kjo marrëdhënie, aq më i vlefshëm është emri i bankës në treg. Bankat përqipen të pozicionohen në mendjet e klientëve me mesazhe të formave të ndryshme, me synim "kapjen" e ndjenjave dhe perceptimeve, të tilla, si: "Tani mundesh", "Ne flasim gjuhën tuaj", ose "Fitoni çdo sfidë". Megjithatë, duhet theksuar se mjaft fushata publicitare gjithnjë e më shumë përqendrohen në "manipulimin" e emocioneve, sesa në ndërtimin e perceptimit.

Imazhi i një banke është produkt i një komunikimi dhe promovimi të brendshëm e të jashtëm me publikun. Sa herë që banka ndërvepron me klientët në forma të ndryshme, ajo përfaqëson një mundësi për të krijuar një marrëdhënie edhe më të fortë, kështu që marrëdhëniet me publikun dhe komunikimi masiv nëpërmjet reklamës paraqesin dy elemente kryesore të komunikimit për bankat, pasi ato e lidhin bankën me publikun e gjerë, në mënyrën më të shpejtë të mundshme. Media është bartësi kryesor i këtij informacioni dhe nëse përdoret me zgjuarsi, mund të krijojë frekuencën e nevojshme të efektshme. Sigurimi i kombinimit të suksesshëm të asaj çka komunikohet me atë se ku komunikohet, si dhe me adresimin drejt audiencës së duhur, që i përgjigjet këtij komunikimi, mund të jetë burimi për të krijuar përparësi konkurruese për një bankë në treg.

Sipas disa të dhënave të ofruara nga MC Monitoring ([www.mcmonitoring.org](http://www.mcmonitoring.org)), mund të krijohet një ide rreth ndarjes së buxhetit në media,

për vitet 2011 dhe 2012. Edhe pse dinamika e medias ka ndryshuar dukshëm, televizioni mbetet ende kanali kryesor i komunikimit me audiencën më të madhe. Më pas vjen reklamimi në mjedise të jashtme (OHH), pasi ai ofron mundësi për të bërë përshtypje e lënë gjurmë, si dhe për të krijuar vetëdije të menjëhershme për fushata taktike. Në rritje të shpejtë është marketimi dixhital, duke qenë se më shumë se një e treta e popullsisë lundron në mënyrë të përditshme në internet. Bankat kanë filluar të njohin vlerën e zgjidhjeve dixhitale, për shkak të raportit pozitiv kosto-përfitim dhe ky është një mjet që mundëson angazhimin me klientët. Bankat po përshtatin prioritetet e tyre për të plotësuar nevojat e klientëve dhe po përqendrohen në angazhimin e klientit përmes zgjidhjeve të reja e më të mira, si: internet dhe mobile banking, ku çdokush mund të kryejë të gjitha llojet e transaksioneve dhe të përdorë opsione ekstra, të tilla, si: aplikacionet për lokalizimin e ATM-ve, që janë më të përshtatshme për "kapjen" e klientëve në lëvizje, duke u ofruar opsione për vetëshërbim etj. Me rritjen e numrit të përdoruesve të internetit, smartphones dhe tablets, është e qartë se prirja do të zhvendoset drejt rritjes së ndërveprimit midis kanaleve të ndryshme, për të "kapur" këtë grup gjithnjë e më të madh klientësh, që përdorin këto teknologji.

Bankat në Shqipëri zakonisht zgjedhin të punojnë me një agjenci marketingu që shquhet për dinamikën krijuese dhe jo vetëm e që mund t'i sigurojë asaj shërbime të blerjes së hapësirës në media. Kjo marrëdhënie është e rëndësishme në rastin e krijimit të strategjive dhe taktikave më të



mira të komunikimit, si dhe për sigurimin e zgjidhjeve më të mira krijuese, që befasojnë tregun dhe krijojnë angazhimin e duhur. Marrëdhënia bankë - agjenci është si një martesë e lumtur (lexo e frytshme), kur të dyja palët kuptojnë njëri-tjetrin, përipiqen fort dhe ndajnë qëllime e objektiva të përbashkëta.


Studimet e tregut tregojnë se klientët e bankave besojnë se reklamimi është efektiv për bankën. Bankat u ofrojnë klientëve informacion mbi llojet dhe karakteristikat e produkteve të tyre, me qëllim që t'i tërheqin ata drejt tyre. Kur klientët përfitojnë

produkte të mira dhe me kushte të mira, ata dëshirojnë që ato të ofrohen nga një bankë që sipikat me praninë e saj brenda mjedisit konkurrues, një bankë që ndjek zhvillimet në sektorin e saj dhe ofron produkte të dallueshme e më cilësore nga konkurrentët e saj. Megjithatë, reklamimi nuk është faktor përcaktues në zgjedhjen përfundimtare që bëjnë klientët. Zgjedhja e një institucioni bankar bazohet në produktet, shërbimet dhe marrëdhëniet që ofron dhe ndërton banka me klientin e saj. Reklamimi, si një element kyç i komunikimit, por dhe për imazhin e biznesit, duhet të jetë

zime aktuale. Por nëse evidentohet se interesi i ofruar nuk është interesi aktual, apo që skema e depozitës shoqërohet dhe me një komision të papërmendur më parë, a do të ndihej ai/ajo i gënjer? A do të shkonte më tej ky klient, sa të paraqiste një ankesë brenda degës? Ndoshta jo, por do ta ndante këtë përvojë me një mikun/miken e tij/saj dhe ndoshta herën tjetër do të tregohet shumë më i/e kujdessh/ëm/me, lidhur me komunikimin me bankën.

Transparenca e produkteve dhe shërbimeve bankare dhe kërkesa për informacion minimal publik në Shqipëri rregullohet nga rregulloret përkatëse të Bankës e Shqipërisë. Gjithashtu, bankat hartojnë procedura të brendshme të përputhshmërisë, me qëllim shmangien e marketimit çorientues dhe që siguron transparencë në komunikimin e tyre me klientët. Sigurisht, jo të gjithë elementët "zbukurues" të reklamimit janë të paligjshme dhe disa banka mund të argumentojnë se ata e respektojnë ligjin, pavarësisht komunikimit disi të mjeçullt, në rastet kur informacioni është qëllimisht i paplotë ose një e dhënë e rëndësishme nuk shfaqet në poster. Tarifat apo kostot e fshehura mund të sigurojnë të ardhura më të mëdha në

Marketimi nuk është faktor përcaktues në zgjedhjen përfundimtare që bëjnë klientët. Zgjedhja e një institucioni bankar bazohet në produktet, shërbimet dhe marrëdhëniet që ofron dhe ndërton banka me klientin e saj. Marketimi, si një element kyç i komunikimit, por dhe për imazhin e biznesit, duhet të jetë tepër i kujdesshëm dhe jo çorientues.



tepër i kujdesshëm dhe jo çorientues. Nëse dikush sheh një poster jashtë një dege banke që shpall norma të larta e të pazakonta interesi – a do të hynte ai/ajo në bankë dhe të kërkonte informacion shtesë? Ndoshta, e kjo nëse personi ndjen nevojën për të bërë një investim të sigurt, ose kur shikon se atij/asaj po i ofrohet gjithashtu përfitimi paraprak i interesit, që mund të përmbushë disa nevoja për shpen-

afat të shkurtër, por kjo do të ketë pasoja afatgjata në besimin e klientit; e kjo krijon përparësi konkurruese për bankat e tjera në treg.

Sigurisht, ajo që ja vlen të diskutohet është ofrimi i produkteve novatore, që u shërbejnë më së miri nevojave të klientëve, si dhe kryerja e marketimit që bazohet në premtime reale dhe krijimtari të pastër, që prodhon interes të mirëfilltë nga klienti.



# Kredia Hipotekore 5 Yje

Interes fiks për vitin e parë

**5.9%** Euro & **7.9%** Lekë

Shlyerje para afatit me **komision 0**



**Fibank**  
First Investment Bank

TELEFONONI PA PAGESË NE  
**0800 01 11**

[www.fibank.al](http://www.fibank.al)



## BASHKIMI BANKAR EUROPIAN - NDËRMJET REALITETIT DHE UTOPISË



**nga Prof. Dr. Adrian CIVICI**  
President & Drejtor i Shkollës  
Doktorale  
Universiteti Europian i Tiranës, UET

Në 13 dhjetor 2012, ministrat e financave të 27 vendeve anëtare të BE-së arritën të bien dakord për një “mbikëqyrje unike të bankave në zonën euro”, duke pranuar heqjen dorë nga mbikëqyrja kombëtare që çdo shtet anëtar ushtronte mbi bankat në territorin e tij. Ky vendim “kompromisi”, që pritet të hyjë në fuqi në mars 2014, erdhi pas një kohe të gjatë diskutimesh, debatesh, mosmarrëveshesh e dilemash që e bllokoi atë, të tilla si: A do të ushtronte e vetme mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë Banka Qendrore Europiane (BQE)? A do të kishte bashkëveprim ndërmjet Autoritetit Bankar Europian (që nënkuptonte tërësinë e vendeve të BE-së) dhe BQE-së (që e kishte autoritetin e saj vetëm në 17 vendet e eurozonës)? A do ishte e mundur të ndaheshin dy funksionet bazë të BQE-së (politika monetare e zonës euro dhe mbikëqyrja që do prekë të gjitha vendet anëtare të BE-së)? A do ishin nën mbikëqyrjen e BQE-së bankat me madhësi aktivesh nën 30 miliardë euro? Së fundi, a do t'i nënshtroheshin mbikëqyrjes nga BQE-ja shoqëri të ndryshme kursim-kreditit dhe bankat rajonale, apo ato do të mbeteshin jashtë këtij sistemi? Vendimi për mbikëqyrjen e përbashkët u konsiderua si “hapi i parë i madh

Për të zgjidhur në mënyrë të qëndrueshme funksionimin e zonës euro, bashkimi bankar duhet të shoqërohet me krijimin e “bashkimit të transfertave buxhetore”, që kërkon ngritjen e një strukture mbikëqyrëse të buxheteve kombëtare dhe një koordinim real të politikave ekonomike në gjithë eurozonën

drejt bashkimit bankar europian”, “si një element çelës në planet e BE-së edhe drejt një Europe bankare dhe zgjidhjen e problemeve të zonës euro”, si një mekanizëm “që do të rikthejë besimin, dhe një sinjal i qartë për gjithë botën, për vitalitetin europian”.

Objektivi i BE-së është tashmë i qartë: krijimi i një bashkimi bankar europian, si një nga sfidat, por dhe problemet më të mëdha strukturore

Vështirësitë dhe dyshimet më të mëdha që duhen tejkaluar kanë të bëjnë me “eliminimin e ndikimit politik, që mund të ushtrohet nga shtete të veçanta europiane”, ndikim ky që ka krijuar jo pak probleme në historinë e sistemit bankar europian, e që lidhen me çështjen delikate të cedimit të sovranitetit nga ana e shteteve anëtare.

të zonës euro dhe të ardhmes së bashkimit monetar europian. Gjatë tre viteve, 2008-2011, mbështetja e bankave i kushtoi BE-së 1,600 miliardë euro, ose 13% të PBB-së së saj vjetore. Kriza e borxheve publike dhe deficiteve buxhetore në përgjithësi, si dhe gjithë problematika e sistemit bankar europian në veçanti, evidentuan mjaft “shigjeta” që rrezikonin të ardhmen e qëndrueshme të tij. Së pari, trysnitë, tolerimet dhe mbështetja ekstra që kërkonte vlerësimi “too big to fail”, që në një farë mënyre nuk të jep mundësi për veprime drastike korrektuese për këto lloj bankash; së dyti, vështirësitë për të neutralizuar kriza të ardhshme bankare e financiare, që mund të provokohen nga shoqëritë e mëdha të sigurimeve (AIG në SHBA ishte një e tillë); së treti, ndërlikimet e mundshme të një reforme radikale apo “revolucionit bankar”, i lidhur me propozimin për një “limited purpose banking”, që parashikonte një reduktim drastik të “leverage”-it bankar nëpërmjet transformimit të institucioneve të kreditit në fonde të hapura investimesh; së katërti, çështjen e bankave të ashtuquajtura “kolosë me këmbë argjili”, si: Dexia, Fortis, ABN AMRO, Royal Bank of Scotland etj.; së pesti, garancinë për stabilitet të mjaft bankave të vogla, por të “rritura në mënyrë agresive” me një mungesë të dukshme ekuilibri ndërmjet huave dhe depozitave, si: Northern Rock, banka islandeze, banka irlandeze etj.; së gjashti, zgjidhjen e problemit

të bankave rajonale, që shpesh janë nën trysni politike e nacionaliste, siç është rasti i mjaft bankave rajonale në Spanjë; së shtati, bankat që destabilizohen si pasojë e ekspozimit të lartë ndaj borxheve sovraane, në mënyrë specifike disa nga bankat më të mëdha greke, franceze, irlandeze etj.

Pyetja më e shpeshtë që bëhet është: Çfarë duhet bërë për të ulur në minimum kostot e kësaj krize, në mënyrë që të rritet rezistenca e sistemit bankar ndaj krizës, apo ndaj krizave të tjera në të ardhmen? Disa nga masat më të rëndësishme të propozuara janë:

1. **Krijimi i një strukture, apo autoriteti evropian mbikëqyrjeje.** Duket se propozimet dhe projektet po konvergjojnë drejt një modeli të ngjashëm me FDIC-në (Federal Deposit Insurance Corporation) amerikane, me një mbikëqyrës pan-evropian, fillimisht për grupet më të mëdha bankare evropiane, e në vazhdim, profilizimi i tij si një mbikëqyrës unik, për të gjithë sistemin bankar evropian. Kjo mbikëqyrje, që do të realizohet nga BQE-ja, si autoriteti unik i mbikëqyrjes, duhet të përfshijë: autoritetin bankar evropian, i ngarkuar me mbikëqyrjen e bankave e veçanërisht rikapitalizimin bankar; autoriteti evropian i tregjeve financiare, i ngarkuar kryesisht me mbikëqyrjen e tregjeve të kapitaleve; autoriteti evropian i ngarkuar me mbikëqyrjen e sektorit të sigurimeve dhe pensione. Me përjashtim të rreth 200 grupeve të mëdha bankare (rreth

1,000 banka), që do mbikëqyrin drejtpërdrejt nga BQE-ja, rreth 6,000 banka të tjera të zonës euro do të vazhdojnë të mbikëqyrin nga autoritetet kombëtare, por BQE-ja mund të ndërhyjë, nëse konstaton probleme strukturore e sistematike. Vështirësitë dhe dyshimet më të mëdha që duhen tejkaluar kanë të bëjnë me “eliminimin e ndikimit politik, që mund të ushtrohet nga shtete të veçanta evropiane”, ndikim ky që ka krijuar jo pak probleme në historinë e sistemit bankar evropian, e që lidhen me çështjen delikate të ceditimit të sovranitetit nga ana e shteteve anëtare. Gjermania, p.sh., që në fillim e bëri të qartë se “duhej bërë diferenca ndërmjet miratimit të kësaj mase dhe futjes në fuqi të saj”. Zgjidhja më e pranueshme duket se është “krijimi i një komiteti mbikëqyrjeje me përbërje mikse, BQE plus përfaqësues të autoriteteve kombëtare të mbikëqyrjes”, i cili do të amortizojë konfliktet e interesit.

2. **Ndërtimi i një mekanizmi të qartë për “rregullimin uniform” të sektorit bankar.** Kriza financiare evidentoi rrezikun që shkaktohet, si pasojë e divergjencave apo “diferencave në rregullat kombëtare të qeverisjes” së sektorit bankar, sidomos për sa i përket nivelit të kapitalizimit të bankave. Në vijim të rekomandimeve të FSB-së (Financial Stability Board) dhe G20-ës, reforma synon ndryshimin e legjislacionit për t’iu përshtatur normave të reja ndërkombëtare, të njohura, si: “Marrëveshja Bazeli III”. Këto rregulla do të zbatohen në mbi 8,000 banka evropiane (6,000 në zonën euro), që në total përfaqësojnë 53% të aktiveve bankare botërore. Në këtë grup masash përfshihen dhe ato që kanë të bëjnë me “rregullimin financiar”, të tilla, si: reformat strukturore të sektorit bankar, sistemet bankare paralele, huat me probleme, produktet deri-

vate, rregullat e negociimit të instrumenteve financiare, praktikatat e shpërblimit në sektorin bankar, reformimi i sektorit të auditit dhe kontabilitetit etj.

3. **Garancia evropiane për depozitat.** Në përputhje me legjislacionin evropian, depozitat bankare, në çfarëdo vendi të BE-së janë të garantuara në masën 100,000 euro për depozitues, për çdo rast falimenti bankash. Përparimi në këtë element ka të bëjë me harmonizimin evropian të këtij sistemi dhe thjeshtimin e funksionimit të tij. Konkretisht, nëse një sistem kombëtar i shteron burimet e tij, ai mund të furnizohet nga sistemet e tjera kombëtare. Thënë ndryshe, kjo duhet të konsiderohet dhe si faza e parë drejt ndërtimit të një sistemi evropian garancie për depozitat. Ky sistem krijon një mbrojtje më të mirë të depozitave në rang evropian, i krijon mundësi qytetarëve evropianë që të zgjedhin se në cilin vend të BE-së t’i depozitojnë kursimet e tyre, pa u kushtëzuar nga rregullat kombëtare. Bankat mund të propozojnë e zbatojnë produkte konkurruese, të shtrira në gjithë BE-në, pa qenë të kufizuara nga diferencat kombëtare. Së fundi, një financim evropian i garancive për depozitat e kufizon shumë nevojën e ndërhyrjes me anë të fondeve publike në këtë sistem. Në shkallë BE-je, garantimi i depozitave do të evitonte panikun bankar në rast krizash kombëtare, si dhe do të kontribuonte në “këputjen” e lidhjes ndërmjet krizave të borxhit sovran dhe krizave bankare.

4. **Krijimi i një fondi evropian për emergjencat, apo zgjidhjen e krizave bankare.** Ky fond, i financuar pjesërisht nga vetë bankat dhe pjesa tjetër nga fondet publike, do të ndihmojë në zgjidhjen e problemeve kritike të atyre bankave që gjenden në vështirësi. Megjithatë, konsensusi dhe mundësitë për krijimin e menjëhershëm të këtij fondi duket akoma i vështirë dhe ai shikohet më tepër si një masë për forcimin e kapaciteteve të bashkimit monetar evropian për zgjidhjen perspektive të krizave bankare.

5. **Ekuilibrimi i raporteve ndërmjet aktiveve bankare dhe PBB-së.** Kjo masë nënkupton vendosjen e disa përpjesëtimeve “normale” ndërmjet aktiveve bankare në ra-





port me PBB-në, për shkak se në shumë vende të BE-së konstatohen diferenca dhe shpërpjesëtime të mëdha, si p.sh.: rastet e Irlandës dhe Islandës, ku aktivitet bankare janë përkatësisht 5 dhe 7 herë më të mëdha se PBB-ja etj. Në këto kushte, parandalimi dhe menaxhimi i krizave bëhet tepër i vështirë.

A është realist e lehtësisht i zbatueshëm bashkimi bankar evropian? Kjo pyetje vijon të shkaktojë debate në gjirin e institucioneve europiane, ekspertëve të sektorit bankar dhe politikanëve kryesorë evropianë. Prej tyre vlerësohet se bashkimi bankar evropian është tejet ambicioz. Argumentet janë të shumta: së pari, BQE-ja vazhdon të mbetet referenca e vetme që po mban mbi shpatulla përgjegjësinë e mbështetjes financiare për vendet me borxhe të mëdha, si: Greqia, Italia e Spanja. Në emër të interesit për euro-n, BQE-ja po i dobëson bilancet e saj, e në disa raste, po del jashtë statutit dhe rolit të saj tradicional. Së dyti, shtrirja e juridiksionit të mbikëqyrjes nga BQE-ja mbi 6,000 banka në gjithë eurozonën duket si një "detyrë e jashtëzakonshme", të paktën me për-

bërjen dhe strukturat që ajo disponon aktualisht. Së treti, fondi evropian i garancisë së depozitave do të kishte me shumë kuptim, nëse do të bëhej fjalë vetëm për aktivitetet klasike bankare (hua - depozita), ndërkohë që pikëpyetjet më të shumta shtrohen kur bëhet fjalë për të mbuluar rrezikun e portofoleve të produkteve derivate e spekulative. Së katërti, vështirësitë e reformës strukturore për të krijuar shpejt një strukturë sa më homogjene të bankave në Europë. Kësaj vështirësie i shtohet dhe fakti se vende, si: Suedia, Anglia, etj, vijojnë të shfaqin dyshime për projektin e bashkimit bankar, duke deklaruar se mund të mbeten jashtë këtij sistemi. Së pesti, çështja e rikapitalizimit të bankave nëpërmjet "Mekanizmit Evropian të Stabilitetit" (MES), vështirësohet si pasojë e dy elementeve: (1) MES ka një rol makroprudencial për stabilitetin e borxheve sovraane të shteteve dhe jo të bankave; (2) BE-ja nuk mund të bëhet aksionare e drejtpërdrejtë të bankat në rast krize. Së gjashti, zona euro akoma nuk zotëron të gjitha elementet rregullatore të një zone monetare optimale. Për të zgjidhur në mënyrë të qëndrueshme funksionimin e zo-

nës euro, bashkimi bankar duhet të shoqërohet me krijimin e "bashkimit të transfertave buxhetore", që kërkon ngritjen e një strukture mbikëqyrëse të buxheteve kombëtare dhe një koordinim real të politikave ekonomike, në gjithë eurozonën.

BQE-ja vazhdon të mbetet referenca e vetme që po mban mbi shpatulla përgjegjësinë e mbështetjes financiare për vendet me borxhe të mëdha, si: Greqia, Italia e Spanja. Në emër të interesit për euro-n, BQE-ja po i dobëson bilancet e saj, e në disa raste, po del jashtë statutit dhe rolit të saj tradicional.

# AUDITIMI I PËRGJEGJËSISË SOCIALE TË KORPORATAVE NË SEKTORIN BANKAR SHQIPTAR



*nga Dokt. Holtjana BELLO<sup>1</sup>  
Konsulente Biznesi në Qeverisje  
Korporatash&Auditim të Brendshëm*

Ndryshimet në Përgjegjësinë Sociale të Korporatave (PSK) në dhjetëvjeçarindekadën e fundit u kanë mundësuar organizatatave, veçanërisht bankave, të ndryshojnë fokusin e biznesit nga maksimizimi i fitimit drejt një qasje më të gjerë, që përfshin respektin ndaj komunitetit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve. Fokusi në rritje i PSK-së ka prekur edhe sektorin privat në Shqipëri. Meqenëse tregu shqiptar është konsideruar treg në zhvillim, ai është ndikuar nga praktikatat më të mira ndërkombëtare. Nëse i referohemi tregut bankar, ekzistojnë dy përbërës që kanë ndikuar zhvillimet e praktikave të PSK-së:

(1) njohja dhe ndërgjegjësimi ndërkombëtar, lidhur me praktikatat e PSK-së, ka luajtur rol kyç në rritjen e ndërgjegjësimin për këto praktika në Shqipëri dhe

"Duhet të ekzistojë një "guidë auditimi", që mundëson kryerjen e auditimeve të rreziqeve sociale, etike dhe të mjedisit në mënyrë të njëtrajtshme, por që gjithashtu iu mundëson bankave ta përshtatin këtë guidë sipas karakteristikave të çdo banke, sipas madhësisë, kapacitetit dhe njohurive të stafit të auditimit".

(2) përshtatshmëria e politikave të PSK-së të zbatuara nga bankat "mëmë", që kanë filiale dhe në Shqipëri.


Por, a është auditimi i PSK-së në sektorin bankar në Shqipëri, pjesë e planeve të punës së auditimit të brendshëm, meqenëse PSK-ja tashmë ka marrë një dimension tjetër? Rezultatet e kërkimit të mëposhtëm të mbledhur nga pyetësorët që ju janë drejtuar Drejtorëve të Departamenteve të Auditimit të Brendshëm të disa bankave

në Shqipëri (66% e bankave, bazuar ne aktive), tregojnë si më poshtë:

## REZULTATE NGA ANKETIMI

### Madhësia e funksionit të auditimit të brendshëm

Madhësia e funksionit të auditimit të brendshëm u mendua fillimisht si një ndër arsytet për të audituar edhe rreziqe sociale, etike dhe të mjedisit. Figura 1 tregon madhësinë e departamenteve të auditimit të brendshëm të bankave në Shqipëri, e matur në ditë produktive pune. Grafiku tregon që 50% e



<sup>1</sup> Shkrimi është pjesë e hulumtimit personal shkencor të autores, të prezantuar në konferencën ndërkombëtare të Universitetit të Tiranës mbi Kontabilitetin dhe Auditimin, shtator 2012.

bankave të intervistuar përdorin 500-1.500 ditë produktive pune (nr. audituesve x ditë pune në vit për çdo auditues) drejt aktiviteteve të auditimit, ndërsa pjesa tjetër (50%) përdor më shumë se 1.500 ditë produktive pune.

### Aktivitetet e auditimit të PSK-së

Lidhur me shkallën e përhapjes së auditimit të rreziqeve sociale, etike dhe të mjedisit, përgjigjet tregojnë një nivel të ulët të aktiviteteve të auditimit në fusha sociale dhe të mjedisit, ndërkohë që nivel më i lartë i aktiviteteve të auditimit u gjet në fushën e rreziqeve etike, për shkak të kërkesave të vendosura nga ligji, si: kodi i punës, rregulloret e Bankës së Shqipërisë mbi transparencën, kërkesat e bankave “mëma”, apo banka aksionare me qendër në vendet e zhvilluara, që i shtrëngojnë edhe bankat bija në Shqipëri të veprojnë në përputhje me standardet e PSK-së (shih figurën 2).

e mjedisit, bazuar në standardet ndërkombëtare ISO 14001. Karakteristikë e përgjithshme për auditimin e PSK-së është që këto rreziqe nuk auditohen të izoluar, por ato shihen të integruara në aktivitetet e auditimit të proceseve përkatëse, p.sh.: auditimi i Departamentit të Burimeve Njerëzore parashikon ditë pune për të audituar çështje etike, për të vlerësuar sistemin që menaxhon ankesat e klientëve, për të vlerësuar skemën e sigurisë së shëndetit të punonjësve etj. Kjo gjë përforcon më tej parimin e integritetit, që auditimi i rreziqeve sociale, etike dhe të mjedisit duhet të jetë në të njëjtën linjë me objektivat ekzistuese të organizatës.



### Burimet e auditimit

Lidhur me burimet e planifikuara për auditimin e rreziqeve sociale, etike dhe mjedisit variojnë nga 1% deri në 7%, ku vlera mesatare e burimeve të planifikuara në auditimin e këtyre rreziqeve është 3%. Karak-

mënyrë që të përshtatet me prioritetet e menaxhimit për çështje të PSK-së.

### Qasje e vullnetshme apo rregullatore e detyrueshme?

Intervistat zbulojnë se qasja vullnetare si model i preferuar për të audituar PSK-në zgjidhet nga gjysma e bankave. Argumenti kryesor për këtë qasje është se këto rreziqe shihen me prioritet nga vetë menaxhimi i bankës. Megjithatë, ata përmendën që duhet të ekzistojë një “guidë auditimi”, që mundëson kryerjen e auditimeve të rreziqeve të sipërpërmendura në mënyrë të njëtrajtshme, por që gjithashtu iu mundëson bankave ta përshtatin këtë guidë sipas karakteristikave të çdo banke (madhësia, kapacitetet dhe njohuritë e stafit të auditimit). Gjysma tjetër e të intervistuarve që mbështetën modelin “rregullativ” të auditimit të PSK-së tregoi që standardizimi i auditimit të PSK, do të përforcojë më tej dhënien e sigu-



Intervistat vërtetuan që rreziqet sociale dhe të mjedisit janë më pak të auditueshme, për shkak të fokusit të bankave shqiptare drejt ecursisë financiare afatshkurtër, më shumë sesa drejt treguesve social-ekonomikë, që mundësojnë qëndrueshmëri afat-gjatë të bankës. Gjithashtu, disa të intervistuar shtuan që stafi i audituesve të brendshëm nuk ka aftësitë dhe kualifikimet e duhura për të audituar rreziqet

teristikë e përgjithshme është që bankat me departamente auditimi me 2.500 + ditë produktive pune, kanë planifikuar 3%-4% të burimeve për të audituar këto rreziqe. Ndërkohë, që banka me përqindjen më të madhe të burimeve të planifikuara për të audituar PSK-në (7%) ka një departament auditimi vetëm me 1.200 ditë produktive pune por ajo, ka ri balancuar prioritetet brenda planit të punës të auditimit, në

risë nga audituesit. Ky model promovon një qasje të njëtrajtshme dhe uniforme të praktikave të auditimit të PSK-së, që mundëson krahasimin e këtyre praktikave dhe shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet bankave. Së fundi, një intervistues shtoi që praktikatat uniforme të auditimit, do t'u mundësojnë bankave të lojtojnë e promovojnë konceptin e përgjegjësisë sociale në gjithë sektorin bankar dhe më tej. (Vijon)

## ALPHA BANK ALBANIA

**Maratona Ndërkombëtare e Tiranës** - Më 21 tetor 2012 për herë të parë në Shqipëri u zhvillua Maratona Ndërkombëtare e Tiranës. Alpha Bank Albania ishte një prej mbështetësve të këtij aktiviteti, duke sponsorizuar vendin e tretë të Maratonës 42 km për femra dhe për meshkuj.

**Bursa Studimi** - Më 26 nëntor 2012, Kolegji Greko Shqiptar "Arsakeio" i Tiranës, organizoi një festë me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Një nga momentet më të veçanta të këtij organizimi ishte kur Drejtori i Përgjithshëm i Alpha Bank Albania, z. Periklis Drougkas, dhuroi dy bursa studimi për dy studente të Kolegjit Arsakeio.

**Ankandi i Heshtur i World Vision** - Në ankandin e heshtur organizuar nga World Vision më 5 dhjetor 2012, drejtori i Përgjithshëm i Alpha Bank Albania, z. Periklis Drougkas, bleu 2 prej fotografive, të cilat ishin realizuar nga vetë fëmijët. Fondi i mbledhur nga ky ankand do të përdoret në projekte të ardhshme të këtij fondacioni.

**Dhurata me rastin e Festave të Fundvitit** - Bordi Drejtues i Alpha Bank - Shqipëri, fondin e caktuar për kartolinat e urimit për festat e fundvitit vendosi ta përdorë për të mbështetur disa institucione. Fondi u dhurua për të plotësuar nevojat e Shtëpisë së të Moshuarve në Fier, Kopshtit të Fëmijëve Nr. 1 në Përmet dhe dy Shtëpive të Fëmijëve në Shkodër.



## BKT

**BKT ndihmon familjet në nevojë të 50 nxënësve të shkollës "Mustafa Kemal Atatürk" dhe të komunitetit rom**

Banka Kombëtare Tregtare, në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës së Turqisë në Tiranë, në kuadër të politikave të përgjegjshmërisë sociale dhuroi 50 pako me ndihma për familjet e nxënësve të shkollës "Mustafa Qemal Atatürk", në Zall Herr. Gjithashtu, BKT në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës së Turqisë në Tiranë dhe Shoqatën e Romëve për Integrim dhe Kundër Trafikimit të Fëmijëve, dhuroi dhe 50 pako të tjera me ndihma për familjet në nevojë nga komuniteti rom në Tiranë. Shpërndarja e pakove, u bë në praninë e zv. ambasadores së Republikës së Turqisë në Tiranë, znj. Bengu Tetik, si dhe përfaqësuesve të BKT-së.



## CREDINS BANK

**Shtresa në nevojë** - Credins Bank u gjend pranë shtresave në nevojë, duke ofruar ndihmë të konsiderueshme ushqimore për Kryqin e Kuq Shkodër. Gjithashtu në këtë fundviti, Credins Bank mundësoi një drekë festive për rreth 100 pensionistë të qytetit të Tiranës.

**Komuniteti** - Gjatë dy muajve të fundit për vitin 2012, Credins Bank mundësoi ndërtimin e një lulishteje model në hyrje të qytetit të Kavajës.

**Sporti** - Me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë në qytetin e Vlorës, Credins Bank mbështeti financiarisht Kampionatin Mbarëkombëtar të Boksit, si dhe pajisi me një sasi të konsiderueshme topa basketbolli ekipin e Flamurtarit.

**Fëmijët** - Aktiviteti më i madh i këtij fundviti konsiderohet blerja e dhuratave për 3.000 fëmijë të moshës 0-3 vjeç në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, për të gjitha çerdhet shtetërore të qytetit të Tiranës.

**Çmime** - Në një ceremoni të veçantë, me rastin e 20-vjetorit të krijimit të Fakultetit të Shkençave Sociale, Credins Bank u nderua me një Certifikatë Mirënjohjeje për kontributin në mbështetjen dhe zhvillimin e Punës Sociale në Shqipëri.



## ■ FIRST INVESTMENT BANK

### Fibank në ndihmë të fëmijëve të fshatit SOS

Për të tretin vit radhazi Fibank kontribuon me fonde në ndihmë të fëmijëve të fshatit SOS. Fondet e dhëna për blerjen e kartolinave për festat e fundvitit përdoren me qëllimin e një shtëpie të ngrohtë për çdo fëmijë që ka nevojë për strehë e familje dhe i ka gjetur këto në këtë fshat. Aktivitete të tilla janë në fokus të Fibank gjatë gjithë kohës, por qëllimi dhe planifikimi është për t'i intensifikuar ato gjatë vitit 2013.



## ■ INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK



### Stafi i ICB dhuron gjak

Stafi i Bankës Ndërkombëtare Tregtare (ICB) në Tiranë iu përgjigj apelit të Kryqit të Kuq për dhurimin vullnetar të gjakut, në ndihmë të fëmijëve talasemikë dhe personave që kanë nevojë për të. Kjo është hera e dytë për këtë vit e dhurimit vullnetar të gjakut nga punonjësit e ICB-së.

### Kontributi i ICB me rastin e festave të fundvitit

ICB gjatë vitit 2012 dhuroi 120 pako për dy qendrat ditore të fëmijëve të pastrehë. Kjo nismë u realizua falë dhurimit që ICB i bëri CRCA-së dhe ALO 116, për t'iu ardhur në ndihmë shtresave më në nevojë të shoqërisë. Me rastin e festave të fundvitit, ICB u gjend pranë edhe fëmijëve të fshatit SOS.

## ■ INTESA SANPAOLO BANK

### “Fëmijët në Bankë” në Intesa Sanpaolo Bank

“Fëmijët në Bankë” ishte nisma e ndërmarrë nga Intesa Sanpaolo Bank në fushën e përgjegjësisë sociale. Qëllimi i kësaj nisme, e mbështetur nga Divizioni Ndërkombëtar i Bankave Filiale të Grupit Intesa Sanpaolo, ishte të mirëpriste fëmijët në bankë, duke u dhënë atyre mundësinë të jetojnë një eksperiencë të veçantë në shoqërinë e prindërve. Në fund të vizitës së tyre, fëmijëve iu shpërndanë pako me dhurata të vogla. Vizatimet e fëmijëve, dedikuar kësaj vizite në bankë, u përdorën si imazh për të prodhuar kartolina për fundvitin, fondet e të cilave iu dhanë Fshatit të Fëmijëve “SOS”.



## ■ NBG BANK ALBANIA

### NBG Bank Albania dhuron libra për 100 nxënës në Sarandë



Me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë, në mjediset e shkollës 9-vjeçare "Adem Sheme" në Sarandë, u organizua një spektakël i veçantë. Të ftuar ishin 100 nxënësit më të mirë të shkollës, të cilët organizuan shfaqje të ndryshme për miqtë e tyre, të afërmit dhe mësuesit. Me këtë rast, NBG Bank Albania dhuroi libra për nxënësit e pranishëm. Gjatë 16 viteve të aktivitetit të saj në Shqipëri, NBG Bank Albania ka mbështetur gjithnjë projektet për zhvillimin e arsimit, duke e konsideruar atë si një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të shoqërisë.

## ■ PROCREDIT BANK

### ProCredit Bank konfirmon angazhimin social në fushën e Agrobiznesit dhe Eficiencës së Energjisë



Projekti "Trekëndëshi i Bashkëpunimit për Biznes" nga ProCredit Bank, është një projekt novator në sektorin e agrikulturës, i cili synon jo vetëm të lidhë dhe koordinojë agropërpunuesit me prodhuesit e lëndës së parë, por ka si synim dhe paraqitjen e modeleve të agrobizneseve në nivel ferme bujqësore e blegtorale me përfitueshmëri të lartë; përmirësimin e teknologjisë në ferma nëpërmjet investimeve në teknika të reja, rritjen e rendimentit si dhe rritjen e konkurrueshmërisë. Në kuadër të këtij projekti, janë realizuar takime në shumë zona bujqësore në Shqipëri, si p.sh.: në qarkun e Durrësit, Tiranës, Fierit, Korçës, Beratit, Vlorës, Shkodrës, Gjirokastrës, Sarandës etj. Një tjetër hapësirë ku ProCredit është treguar socialisht aktive është promovimi i "Eficiencës së Energjisë", jo vetëm si një produkt financiar, por si një mënyrë investimi, që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së jetesës së individëve, uljes së shpenzimeve mujore për energjinë, si dhe zvogëlon ndikimin negativ të ndotjes në mjedisin që na rrethon.

## ■ RAIFFEISEN BANK

### Raiffeisen Bank mbështet aktivitetin për fëmijët jetimë në festat e fundviti

Raiffeisen Bank mbështeti aktivitetin e titulluar: "Festat e fundviti pasion i fëmijëve jetimë, i festojmë të gëzuar në komunitet", që u organizua nga Shoqata "Jetimët në Fokus" në mjediset e Teatrit Kombëtar të Kukullave Tiranë. Në këtë festë morën pjesë 220 fëmijë jetimë nga Tirana, Berati, Kavaja, Çorovoda dhe Poliçani. Në fund të koncertit u shpërndanë dhurata për fëmijët pjesëmarrës.

## ■ TIRANA BANK

Tirana Bank dhuron gjak për Kryqin e Kuq Shqiptar - Për të katërtin vit radhazi, punonjësit e Tirana Bank kanë mbështetur Kryqin e Kuq Shqiptar. Mbi 200 punonjës dhuruan gjak, për t'i ardhur në ndihmë veçanërisht fëmijëve që vuajnë nga sëmundja e talasemisë dhe leucemisë. Në emër të stafit të Tirana Bank, drejtori i Përgjithshëm, z. Savvas Thalassinios, dha një mesazh solidariteti dhe mbështetje për këtë nismë të përvitshme.

"Ndërmendje 2012" - Koncerti i muzikës klasike "Ndërmendje" pasqyron qartë shpirtin artistik të qytetit të Shkodrës, duke sjellë çdo fundvit pjesë të mrekullueshme klasike nga autorët më të njohur të huaj e vendas. Tirana Bank vijoi mbështetjen e kësaj shfaqjeje edhe për këtë vit.

Çmime - Qendra për Ndryshim dhe Menaxhim Konflikti "Partners Albania", organizoi për të dytin vit radhazi Çmimin e Filantropisë 2012 për Shqipërinë. Tirana Bank iu akordua "Certifikata e Mirënjohjes", me motivacionin: "Për kontributin e çmuar dhe humanitar të dhurimit vullnetar të gjakut, në mbështetje të vazhdueshme të Bankës së Gjaku dhe Qendrës së Transfuzionit të Gjaku" me shtrirje në të gjitha degët ku operon.

Festa e Verërave - Nën një atmosferë shumë të gëzueshme fundviti, u zhvillua në Pogradec "Festa e Verërave 2012". Nuk mungoi dhe këtë vit ndihma e Tirana Bank, me synim paraqitjen e traditës dhe mbështetjen e sipërmarrësve vendas, të cilët promovojnë prodhimin vendas të verës.





## UNION BANK

**Union Bank mbështet aktivitetin për çmimet letrare rajonal "Gjergj Fishta"**

Union Bank, mbështeti aktivitetin rajonal për çmimet letrare "Gjergj Fishta", dhënë nga klubi letrar "Ndoc Gjetja". Aktiviteti u organizua në Fishtë më 3 nëntor 2012, në bashkëpunim me Union Bank, Këshillit të Qarkut Lezhë dhe klubit letrar "Ndoc Gjetja". Gjatë aktivitetit u ndanë çmime për poetët dhe prozatorët më në zë të Shqipërisë, si: Agron Tufa, Bardhyl Londo, etj.



## VENETO BANKA

**"Marina e Orikumit. Lundrimi për argëtim dhe turizëm detar"**

Në fund të muajit tetor 2012, Ambasada Italiane në Tiranë, në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë së Italisë në Shqipëri, me mbështetjen e Veneto Banka, organizoi një konferencë për zhvillimin e turizmit detar, duke marrë shkas nga projekti "Marina Orikum", një investim mjaft i dobishëm dhe shumë i vlefshëm për zhvillimin e turizmit, si dhe lundrimin detar në Shqipëri.

Puna promovionale sapo filloi me këtë konferencë të parë dhe pritet të pasojë me të tjera aktivitete mjaft me vlerë për promovimin e Marinës së Orikumit.



## PLATOR ULQINAKU, BANKIERI ME PASIONIN PËR POEZINË



**N**e e kemi njohur si njeri të përqendruar në punën e tij, ku prej 12 vitesh përballet me sfidat, stresin dhe kënaqësinë që të fal puna si bankier. Në qendër të vëmendjes tonë në këtë rubrikë të re është z. Plator Ulqinaku, kësaj here jo si drejtor i Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut në Union Bank, por si një poet dhe fitues i një çmimi kombëtar të letërsisë.

Çmimet Kombëtare të Letërsisë u shpallën në dhjetor 2012 dhe kishin për qëllim të vlerësonin titujt më të mirë të hapësirës mbarëkombëtare letrare. Z. Plator Ulqinaku u vlerësua si autori më i mirë debutues i vitit 2011, me Çmimin "Migjeni". Vëllimi i tij "Libri i qëndresës" u vlerësua "për një hap të parë të pjekur dhe premtues në poezinë shqipe". Ky është libri i parë që ka shkruar Platori.


Ky vëllim është një libër voluminoz, të cilin autori e cilëson njëkohësisht katotik për nga tematika, shumëngjyrësh dhe të vështirë për ta përcaktuar. Platorit i pëlqen të shkruajë poezi frazeologjike me blloqe kuptimore, të cilat nuk ecin me vargje. Gjithashtu, ai shkruan dhe poezi eseistike mbi idetë dhe temat e krijimit, Zotit, dashurisë, iluzionit, utopisë.

"Letërsia është akt fisnik dhe e disavantazuar krahasuar nga ar-

tet e tjera. Nëse artet e tjera përdorin transformimin e lëndës për të tejçuar një temë, letërsia nuk e ka këtë luks. Letërsia ka vetëm sublimim dhe përdorimin e fjalës. Sublimimi duhet të jetë në shkallën sipërore, në mënyrë që dhe letërsia të jetë e tillë", tha z. Ulqinaku gjatë ceremonisë së ndarjes së çmimeve. "Njeriu është qenie racionale dhe irracionale njëkohësisht", u shpreh në një intervistë për median Plator Ulqinaku. Pikërisht në një kontradiktë të tillë ekziston, sipas tij, mundësia e bashkëjetesës së pasionit për poezinë dhe profesionit si bankier.

Plator Ulqinaku është një bankier plotësisht i përqendruar në punën e tij, por gjithashtu një njeri spontan, që di të kthejë detajet artistike në poezi.





Vlerësojmë mbështetjen tuaj

**Dega Toptani dhe Head Office**

Pruga "Murat Toptani"

(Eurocol Center)

Tirane Albania

Tel: 4 2256 254 / 2254 372 / 2235 406

Fax: 4 2235 409 / 2254 368

Email: [toptani@icbank-albania.com](mailto:toptani@icbank-albania.com)

Themeli i një sipërmarrje është besimi. Për 15 vite, ju, klientët tanë keni besuar në vizionin tonë për vlerat bankare. Ambicja dhe angazhimi ynë në vlera të shkëlqyera bankare bazohet në parimet e Besimit, Përballueshmërise, Thjeshtësisë dhe Transparencës. Vlerësojmë mbështetjen tuaj duke drejtuar sipërmarrjen tonë me integritet dhe profesionalizëm dhe do të vazhdojmë të ndjekim vizionin e vlerave bankare duke krijuar platforma me produkte dhe shërbime, të cilat vendosin ju, klientët tanë, në plan të parë



## LAJME NDËRBALLKANIKE

## BOSNJE - HERCEGOVINË




### Rritje rekord e depozitave bankare të individëve me 5% në Bosnjë - Hercegovinë

*Balkans.com - 31.10.2012*

Sipas të dhënave të publikuara nga Banka Qendrore e Bosnjë - Hercegovinës (CBBH), depozitat bankare të individëve shënuan një rritje prej 5% në fund të shtatorit 2012, në krahasim me fundin e vitit 2011, pavarësisht gjendjes së vështirë ekonomike dhe krizës financiare. Kjo vjen nga rritja e depozitave me afat të gjatë maturimi. Ky është treguesi më i mirë i besimit në sektorin bankar, si dhe rezultat i ekzistencës së skemës së sigurimit të depozitave, qëllimi kryesor i së cilës është rritja e stabilitetit të sektorit bankar dhe mbrojtja e depozituesit.

## BULLGARIA



### Bullgaria do të behet pjesë e një sistemi të vetëm të mbikëqyrjes bankare

*Focus Information Agency - 19.10.2012*

Ministri i Jashtëm i Bullgarisë, Nikolay Mladenov, në një deklaratë për kanalin televiziv "Bulgaria On Air", tha se Bullgaria do të jetë pjesë e një sistemi të vetëm bankar, pasi vendi dëshiron të hyjë në eurozonë. "Sa më uniforme dhe të qëndrueshme të jenë rregullat e BE-së, aq më efektive



është marrëdhënia ekonomike ndërmjet Bullgarisë dhe vendeve të tjera europiane", tha Mladenov.

## KOSOVA



### Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) prezanton Raportin e Stabilitetit Financiar të Kosovës

*BQK - 19 dhjetor 2012*

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës prezantoi numrin e tretë të Raportit të Stabilitetit Financiar të Kosovës. Duke informuar publikun mbi gjendjen e sektorit financiar, BQK synon të ngritë transparencën dhe të nxisë debatin profesional mbi zhvillimet dhe sfidat e sektorit financiar të vendit. Fillimisht u shfaq një video e realizuar nga FMN-ja për Kosovën, e cila u shfaq ekskluzivisht gjatë mbledhjeve vjetore të FMN-së dhe Bankës Botërore në Tokio, në tetor të këtij viti. Me këtë rast, BQK shpërndau edhe çmimet për studimin më të mirë të paraqitur nga ekonomistët e rinj.

## KROCIA



### Banka Qendrore e Kroacisë parashikon rritje ekonomike 0,3% në 2013

BNE - 14.12.2012

Ekonomia e Kroacisë duhet t'i kthehet rritjes në 2013-ën, pas një rënie gjatë katër viteve të fundit, duke shënuar një rritje modeste prej 0.3%, edhe pse ekziston rreziku i rënies së vlerësimit të besueshmërisë, tha guvernatori i Bankës Qendrore, sipas agjencisë REUTERS. Parashikimi i bankës është më i ulët në krahasim me parashikimin e qeverisë për rritjen prej 1.8% në 2013 dhe gjithashtu më i ulët se një sondazh i kryer nga REUTERS, për një rritje prej 0,4%. Megjithatë, shefi i Bankës Qendrore, z. Boris Vujcic, tha se pritshmëria për një rritje modeste mund të jetë e paarrtshme, duke paralajmëruar se projektet për investime nga shoqëritë publike mund të jenë "pak ambicioze". Pakësimi i konsumit individual dhe ulja e shpenzimeve publike, kryesisht në formën e shkurtimeve në pagat e sektorit publik, do të ketë një ndikim negativ në rritjen e vitit të ardhshëm.

## GREQIA



### Humbjet në sektorin financiar parashikohen në vlerën prej 46,8 miliardë euro

Ekathimerini - 28.12.2012

Humbjet e bankave vendase për shkak të huave të këqija

në Greqi dhe jashtë vendit përmbledhen në shumën prej 46,8 miliardë euro, ndërsa nevojat e rikapitalizimit të sektorit lokal të kreditit janë vlerësuar në mbi 40 miliardë lekë, njoftoi Banka e Greqisë.

Raporti në rikapitalizimin dhe ristrukturimin e sektorit bankar grek, i hartuar nga Banka Qendrore e vendit, vlerëson rrezikun e besueshmërisë sipas përcaktimit nga BlackRock në 36.8 miliardë euro, si dhe 8.2 miliardë euro humbje nga portofoli i huave jashtë vendit dhe 1.8 miliardë euro hua, që u janë dhënë shoqërive të lidhura me Qeverinë greke. Shuma prej 46.8 miliardë euro, së bashku me 37.7 miliardë euro nga ristrukturimi i borxhit në mars 2012, arrin në 84.5 miliardë euro, që përbën 42% të produktit të brendshëm bruto në vend.

## MALI I ZI



### Rigjallërimi i kreditimit dhe reduktimi i huave me probleme mbeten sfidat kryesore në sektorin bankar të Malit të Zi

MNNNews - 05.10.2012

Në një nga takimet e përfaqësuesve të Bankës Qendrore (CBCG) dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), u arrit në përfundimin se stabiliteti financiar i Malit të Zi është përforcuar me rikapitalizime të reja, ndërsa rigjallërimi i aktivitetit të huadhënies dhe ulja e huave me probleme mbeten sfidat kyçe në sektorin bankar. Në një takim të Guvernatorit të CBCG-së, z. Radoje Zugic, me përfaqësuesit e FMN, Ilahi Nadeem, dhe Matthew Gaertner, u konkludua se Mali i Zi pati një rikuperim të vazhdueshëm të kursimeve dhe depozitave. Gjithashtu, fluksi i investimeve të huaja të drejtpërdrejta mbetet ende në një nivel të lartë.



## MAQEDONIA



### **Banka Qendrore e Maqedonisë lehtëson politikën monetare**

*MIA - 30.11.2012*

Ulja e normës së interesit nga  $\frac{1}{2}$  në 1 për qind për huat ndaj shoqërive të eksportit dhe projektet lidhur me prodhimin e energjisë elektrike, do të vihet në jetë nga masat e reja të ndërmarra prej Bankës Kombëtare të Republikës së Maqedonisë (NBRM), që u miratuan nga Këshilli Drejtues i Bankës.

Guvernatori i NBRM-së , z. Dimitar Bogov, tha se ishte një masë e pazakontë në lidhje me politikat monetare, që synon zbutjen e efekteve të krizës.

## RUMANIA



### **Banca Transilvania në Rumani përfiton një hua prej 30 milionë euro nga BERZH**

*Ovidiu Posirca - Business Review - 24.10.2012*

BERZH ka mbështetur me një hua prej 30 milionë euro Banca Transilvania (BT). Ky fond do të përdoret për financimin e projekteve të SME-ve në Rumani. Një e treta e financimit do të përdoret për eficientë e energjisë dhe projektet e energjisë së rinovueshme. BERZH, që zotëron 16 për qind të aksioneve në Banca Transilvania, ka investuar deri tani rreth 6 miliardë euro në Rumani.

## SERBIA



### **BEI aprovon huan prej EUR 100 milionë euro për mbështetjen e SME-ve**

*European Commission Press - 27.11.2012*

Banka Europiane për Investime (BEI) nënshkroi aprovimin e një fondi prej 100 milionë euro me dy institucione bankare lokale, në mbështetje të projekteve të SME-ve dhe projekteve të infrastrukturës, të promovuara nga autoritete lokale. Huat janë të modeluara në mënyrë të tillë që të mbështesin përpjekjet e Serbisë për t'u integruar në BE. "Banka e Bashkimit Europian mbështet projektet në Serbi me synimin të ndihmojë vendin në rrugën drejt anëtarësimit në BE dhe integrimin e shpejtë në të. Huat e nënshkruara me dy bankat lokale do të mundësojnë financim afatgjatë me kushte të favorshme për SME-të serbe", tha Dario Scannapieco, zv/president i BEI-t, përgjegjës për operacionet në Ballkanin Perëndimor. Ai pohoi se këto hua përfaqësojnë një vazhdimësi të marrëdhënieve shumë të suksesshme ndërmjet BEI-t, Raiffeisen Banka Beograd dhe Erste Bank.

## TURQIA



### **Sektori bankar Turk tërheq më shumë aktorë ndërkombëtarë**

*Balkans.com - 25.12.2012*

Sektori bankar turk po tërheq gjithnjë e më shumë lojtarë ndërkombëtarë, pasi Agjencia e Mbikëqyrjes dhe Rregullimit Bankar (BDDK), miratoi kërkesën e "The Bank of Tokyo-Mitsubishi - UFJ". Shoqëria "Anadolu Endüstri Holding" njoftoi Bursën e Stambollit (IMKB) se ka filluar diskutimet me Bankën Kombëtare të Katarit, për shitjen paketës kontrolluese të aksioneve në Alternatifbank.



## Mundem

DEPOZITA E RE ME AFAT

- Me afat 2 vjet
- Interesi çdo 6 muaj
- Informim me SMS falas

## SIGURI PËR TË ARDHMEN, DUKE PLOTËSUAR KËRKESAT E TYRE TË MOMENTIT

Për këtë arsye Banka Intesa Sanpaolo ju ofron depozitën e re me afat **MUNDEM**. Siguroni investimet tuaja dhe përfitonit nga interesi çdo 6 muaj, duke mos pritur fundin e afatit të maturimit të depozitës, në mënyrë që të plotësoni kërkesat e tyre të përditshme. Për më tepër, merrni njoftim falas me SMS në datën kur ju kreditohet interesi. Dhe mos harroni, mund ti sillni paratë tuaja nga një bank tjetër pa asnjë komision!



**INTESA SANPAOLO BANK**

*Drejt të ardhmes me ju.*

## PORTALI I RI ONLINE “aab-ankande.com”



nga **Brunilda KOSTARE**  
Këshilltare Ligjore  
AAB

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), po shkon drejt përmbylljes së projektit të saj për krijimin e një portali online, në të cilin mund të gjendet një informacion i plotë rreth zhvillimit të ankandëve të pasurive të paluajtshme të vëna, si kolateral, si dhe për pasuritë e paluajtshme në pronësi të bankave, që janë në shitje. Realizimi i këtij projekti vjen si rezultat i një pune

Tashmë çdo i interesuar mund të informohet mbi ankandet e pasurive të paluajtshme të vëna si kolateral, si dhe mbi shitjen pasurive të paluajtshme në pronësi të bankave, nëpërmjet faqes së internetit “aab-ankande.com”.

disamujore, të organizuar nga Sekretariati i Shoqatës, me pjesëmarrjen dhe kontributin e përfaqësuesve të bankave anëtare.

Qëllimi i krijimit të këtij portali është rritja e transparencës së procedurave të ankandëve për shitjen e pasurive të paluajtshme (nga përmbauesit) të vëna si kolateral për huat bankare, duke synuar kështu në një ekzekutim më eficient të kolateralit, çka nënkupton rritjen e numrit të shitjeve në ankande, mbledhjen e detyrimeve, shtimin e likuiditetit, e si rrjedhojë, edhe rritjen e huas për ekonominë.

Gjithashtu, krijimi i tij do të shërbejë dhe si një burim i ri informacioni

për publikun e gjerë, të interesuar për blerje të pasurive të paluajtshme, ku ai mund të informohet mbi të gjitha ankandet e shitjeve të pasurive të paluajtshme të vëna si kolateral për huat bankare, sipas procedurave përkatëse ligjore, në rastet e mosshlyerjeve të këtyre huave. Informacion të dobishëm do të ketë në portal edhe mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme në pronësi të bankave që janë në shitje. Në këtë faqe interneti do të ketë një informacion të plotë rreth ankandëve që zhvillohen nga përmbauesit, si: data e fillimit dhe data e zhvillimit të ankandit; emri dhe adresa e përmbauesit, lloji, struktura, sipërfaqja dhe adresa e pronës, që do të shitet në ankand, si dhe çmimi fillestar i ankandit. Gjithashtu, është parashikuar mundësia e marrjes së një informacioni më të detajuar mbi ankandin nëpërmjet kontaktimit të “Personit të Kontaktit”.

Përveç informacionit mbi ankandë në këtë faqe do të ketë edhe informacion mbi pasuritë në pronësi të bankave të cilat janë në shitje. Çdo i interesuar mund të gjejë informacion të plotë mbi pronën në shitje dhe gjithashtu nëpërmjet numrit të kontaktit mund të informohet më tej për kushtet e shitjes së pronës.

Aktualisht bankat anëtare të AAB-së kanë nisur hedhjen e informacioneve përkatëse në këtë faqe interneti dhe së shpejti kjo faqe do të jetë funksionale, në shërbim të publikut të gjerë. Aab ka parashikuar gjithashtu dhe zhvillimin e një fushate publicitare për lançimin e saj.

## PESË K-TË E ANALIZËS SË HUAS



nga Junida TAF AJ (Katros hi)  
Specialiste Operacionesh  
AAB

Kur një biznesmen shkon në bankë për të kërkuar hua, pyetja më e zakonshme që i bën bankierit është: “Nëse kam nevojë të marr hua, çfarë do të kërkonte nga unë dhe për biznesin tim?”

Pavarësisht se prej kujt kërkojnë fondet hua - nga një bankë apo institucione të tjera huadhënëse - ky huadhënës patjetër që do të shqyrtojë besueshmërinë e kërkuarit të huas. Një kërkesë e plotë dhe plotësisht e dokumentuar për hua (përfshirë këtu dhe planin e biznesit) e ndihmon huadhënësin të kuptojë siç duhet huamarrësin dhe biznesin e tij. Me standardizimin e hapave të shqyrtimit të huave të reja apo atyre ekzistuese, departamenti i huadhënies minimizon mundësinë e pagesave të çrregullta dhe/ose humbjet nga huat me probleme. Elementët kyç cilësorë dhe sasiorë që shqyrtohen gjatë analizës së huas njihen si “5 K”-të e huas, Kapaciteti, Karakteri, Kapitali, Kolaterali dhe Kushtet.

**Kapaciteti** nënkupton aftësinë ligjore dhe financiare të huamarrësit për të marrë hua. Konsiderata e parë në analizimin e kërkesës për hua lidhet me faktin nëse perso-

Standardizimi i hapave të shqyrtimit të një praktike të re, apo ekzistuese të huas, e ndihmon departamentin e huas të minimizojë mundësinë e pagesave të çrregullta të kësteve të huas dhe huat me probleme nga klientët

ni kërkuar ka ligjërisht mundësi të marrë hua. Përveç spektrit ligjor, ky faktor merr parasysh dhe mundësitë financiare të huamarrësit. Aftësia për të ripaguar huan, pra disponimi i fondeve në parë, është më kritikua nga të pesë faktorët. Huadhënësi merr në shqyrtim rrjedhat e parash që do të prodhohen nga biznesi, kohëzgjatjen e ripagesave, dhe probabilitetin e ripagimit të suksesshëm të huas. Historiku i shlyerjes së pagesave të një marrëveshjeje huaje - qoftë kjo personale apo tregtare - konsiderohet si tregues i ecurisë së ardhshme të pagesës së huas.


**Karakteri** lidhet me aftësinë (mundësinë) e huamarrësit për të ripaguar detyrimet dhe dëshirën e tij për t'i shlyer këto detyrime, sipas kushteve të kontratës. Kjo kërkon një shqyrtim të kujdesshëm të sjelljeve dhe historikut të mëparshëm të ripagesave të detyrimeve të huamarrësit. Përfshirja e këtij faktori në analizën e huas është shumë e rëndësishme, pasi sa më i mirë reputacioni i huamarrësit, aq më pak është i prirur ai të dështojë në shlyerjen e detyrimeve. Përfitimi që huamarrësi ka nëse dështon në shlyerjen e detyrimeve është pikërisht shumica e fondeve që ai nuk i shlyen bankës, por përfitimi nga shlyerja e huas është sa vlera ak-

huas çon në humbjen e kësaj NPV-je. Sigurisht, vlera e NPV-së rritet me uljen e normave të interesit për huat e ardhshme. Për më tepër, sa më i gjatë historiku i shlyerjeve të huave nga ana e huamarrësit, aq më e lartë është besueshmërisë e tij, e aq më të ulëta do të jenë normat e interesit për huat e ardhshme të tij. Kështu, përfitimi nga

Analiza e huas shqyrton ata faktorë që mund të çojnë në një dështim të mundshëm të shlyerjes së huas. Objektivi kryesor i saj është të përcaktojë aftësinë dhe vullnetin e huamarrësit për të ripaguar huan.

ripagesa e huas (ose kosto e dështimit) është më e madhe për një huamarrës me reputacion të mirë. Thënë ndryshe, përfitimi i ndërtimit dhe mbarëvajtjes së një reputacioni të mirë është më i madh, sa më i mirë të jetë që në fillim. Pra huamarrësit me reputacion (historik shlyerje) të mirë, priren të kenë rrezik më të ulët të besueshmërisë.

**Kapitali** Sasia e kapitalit të vet (si raport ndaj totalit të aktiveve), që huamarrësi investon në biznesin e tij është një faktor i rëndësishëm në vlerësimin e rrezikut të besueshmërisë së biznesit të tij. Ky faktor ka dy efekte ndikuese. Së pari, sasia më e lartë e kapitalit zvogëlon problemin e dëmit moral. Së dyti, një sasi më madhe kapitali e vënë nga pronarët e firmës, jep një sinjal më të mirë rreth besimit që ata kanë në perspektivën e ardhshme të firmës. Kapitali ndihmon në zgjidhjen e problemit të



tuale neto (NPV) e të gjithë projekteve të tij të investimit, që mund të financohen me hua të ardhshme bankare. Për rrjedhojë, dështim në pagesat e



dëmit moral, duke e zhvendosur drejt huamarrësit barrën më të madhe të humbjes nga pasojat e projekteve të dobëta. Kjo, pasi kapitali është "vija e parë e mbrojtjes" ndaj humbjeve të projekteve të investimit, si dhe shërben si një mburojë mbrojtëse për huadhënësin. Funkzioni tjetër i kapitalit lidhet me rolin e tij si komunikues i informacionit. Kontributi i sipërmarrësit në kapital mund të sinjalizojë rreth përfitueshmërisë së projektit të tij.

**Kolaterali**, ose garancia, përfaqësojnë forma shtesë të sigurisë që i ofrohen huadhënësit të huas. Ofrimi i kolateralit për huadhënësin, nënkupton ofrimin e një aktivi që huamarrësi ka në zotërim, si p.sh.: një shtëpi, me kushtin që ai (kolaterali) do të shërbejë si burim ripagese, në rast të pamundësisë së shlyerjes së huas nga ana e huamarrësit. Nga ana tjetër, garancia është vetëshpjeguese - pra që dikush tjetër nënshkruan një dokument garancie, që premtos shlyerjen e huas, në rast të dështimit të shlyerjes së huas nga huamarrësi. Gjithsesi, përdorimi i kolateralit nuk është pa kosto. Meqenëse huamarrësi mund të ndër marrë veprime që e ulin vlerën e kolateralit për bankën, atëherë kërkohet monitorim i vazhdueshëm i kolateralit. Për më tepër, kur kolaterali i transferohet bankës, pas dështimit të huamarrësit për shlyerje të huas, shfaqen kostot e likuidimit, që përfshijnë kostot ligjore të transferimit të pronësisë, si dhe kostot e bankës për marrjen fillestare në pronësi dhe shitjen e kolateralit.

**Kushtet** kanë të bëjnë me qëllimin e huas, pra do të përdoren fondet e marra hua për kapital punues, pajisje shtesë, apo për inventarë? Këtu huadhënësi merr parasysh dhe kushtet e ekonomisë në përgjithësi, si dhe klimën e përgjithshme të biznesit, brenda industrisë së huamarrësit dhe në industrinë e tjera, që mund të ndikojnë në të. Borxhet paguhen nga katër burime: të ardhurat, shitja e aktiveve, shitja e aksioneve dhe huat nga burime të tjera, të cilat vlerësohen me qëllim që të përcaktohet përshatshmëria, çmimi dhe kushtet e tjera të huas. Aftësia e huamarrësit për të krijuar të ardhura varet nga: çmimet e shitjes së mallrave të tij, kostot e lëndëve të para, konkurrenca, cilësia e mallrave dhe shërbimeve, efektiviteti i reklamës dhe cilësia e menaxhimit. Analiza e pasqyrave financiare të huamarrësit, si dhe menaxhimi i tij, janë një burim informacioni për bankën, lidhur me aftësinë e huamarrësit për të krijuar të ardhura.

## "HISTORIKU I BANKAVE NË SHQIPËRI", PROMOVIMI I LIBRIT, 04 DHJETOR 2012



Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), në kuadër të 100-Vjetorit të Pavarësisë, promovoi botimin e saj mbi historikun e Bankave në Shqipëri në një ceremoni të mbajtur në Hotel Sheraton, Tiranë. I shkruar nga tre bankierë dhe akademikë të njohur, libri mbulon historikun e bankave në vend që prej fillimit të shekullit të nëntëmbëdhjetë deri më sot. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin personalitete të ekonomisë e sistemit bankar, politikës dhe bizneseve, si dhe përfaqësitë e huaja në Shqipëri.

Kryetari i Shoqatës së Bankave, z. Seyhan Pencabligil, bëri një prezantim të shkurtër të librit dhe falënderoi

të gjithë bashkëpunëtorët që mundësuan realizimin e këtij botimi. Gjithashtu, ai shprehu bindjen e tij që shekujt përpara nesh do të jenë më të ndritshëm e të begatë për popullin shqiptar dhe bankat do të vazhdojnë të kontribuojnë në këtë drejtim.

Ceremonia u ndoq nga zv.ministri i Financave, z. Nezir Haldedaj, znj. Elisabeta Gjoni, zv.guvernatore e Parë e Bankës së Shqipërisë dhe nga z. Petraq Milo, këshilltar Ekonomik i Kryeministrit, të cilët në fjalën e mbajtur theksuan rëndësinë e këtij botimi.

Në këtë ceremoni, AAB nderoi me çmime mirënjohje disa ish-bankierë që ndër vite kanë dhënë kontributin e tyre për zhvillimin e sistemit bankar në Shqipëri, si: Dhimitër Pasko i njohur ndryshe dhe si Mitrush Kuteli, Sofokli Memo, Kamber Myftari, Thoma Semi, Llazi Balliu, Andon Thimjo dhe Fori Bici. Vlerësimi i tyre vjen pas propozimit të bërë nga Shoqata Shqiptare e Bankave me motivacionin "Për kontributin e tyre në sistemin bankar".



## AKTIVITETET E SHOQATËS SHQIPTARE TË BANKAVE

### AAB - PËR EDUKIMIN FINANCIAR

AAB dhe Banka e Shqipërisë mundësojnë tekstin “Financat Personale në Duart Tuaja”, 30 tetor 2012

AAB, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë mundësuan për këtë vit shkollor shpërndarjen falas për 4000 gjimnazistë në rrethe të ndryshme të Shqipërisë të tekstit mësimor: *“Financat personale në duart tuaja”*. Prezantimi i kësaj nisme të AAB-së u krye në mjediset e gjimnazit “Partizani” në Tiranë. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin: z. Ardian Fullani, guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Seyhan Pencabligil, kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe drejtor i Përgjithshëm i BKT-së dhe përfaqësues të Drejtorisë Arsimore të rrethit.



AAB dhe IFC promovojnë faqen e internetit për Eficiencën e Energjisë, 18 dhjetor 2012

AAB dhe IFC organizuan aktivitetin me temë: “Promovimi i faqes së internetit për Eficiencën e Energjisë”. Kjo faqe është përgatitur nga AAB, në bashkëpunim me IFC, për të ndihmuar dhe edukuar publikun e gjerë, lidhur me Eficiencën e Energjisë dhe huan për Eficiencën e Energjisë në drejtim të përkufizimeve, përfitimeve, rregullave praktike dhe investimeve për Eficiencën e Energjisë. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin përfaqësues të bankave tregtare, që operojnë në Shqipëri, si dhe përfaqësues të bizneseve, ofrues të produkteve të eficientës së energjisë. Credins Bank, ProCredit Bank dhe Societe Generale Albania prezantuan produktet që ofrojnë për financimin e investimeve në banesa dhe mjedise biznesi, që kanë për qëllim përdorimin eficient të energjisë.

### AAB - TRAJNIME PËR BANKIERËT

Trajnim mbi “Operacionet e huave dokumentare”, 8-10 tetor 2012

AAB në bashkëpunim me Shoqatën e Bankave për Europën Qendrore dhe Lindore (BACEE) organizoi një kurs trajnimi tregtar me temë: “Operacionet e huave dokumentare”, drejtuar nga z. Pavel Andrlle, sekretari i Komisionit Bankar të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë së Republikës Çeke dhe anëtar i Komisionit Bankar të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC). Fokus kryesor i këtij trajnimi ishin procedurat, rreziqet, rregullat ndërkombëtare dhe ofrimi i tyre në praktikë. Trajnimi u ndoq nga 16 punonjës të 12 bankave anëtare.



Trajnim mbi “Operacionet e Garancive”, 11-12 tetor 2012

AAB në vijim të bashkëpunimit me BACEE - n organizoi një trajnim mbi Operacionet e Garancive. Trajnimi u ndoq nga 14 pjesëmarrës nga departamentet e financës, ato ligjore dhe të operacioneve të 10 bankave anëtare. Objektivi kryesor i kursit ishte identifikimi dhe përdorimi praktik i Garancive Bankare dhe Letër Kredite të hapura.

Workshop për teknikat e menaxhimit të huave me probleme, 29 tetor 2012

AAB, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe me mbështetjen e Vienna Financial Sector Advisory Centre (FinSAC) dhe Bankës Botërore, organizoi një workshop për teknikat e menaxhimit të huave me probleme. Workshop-i u prezantua nga ekspertet e McKinsey dhe u ndoq nga më shumë se 50 pjesëmarrës nga bankat anëtare dhe nga Banka e Shqipërisë.



Trajnim për drejtues të sigurisë fizike mbi çështjet e sigurisë dhe shkëmbim eksperience reciproke, 14 nëntor 2012

AAB në bashkëpunim me ICTS Albania, organizoi një kurs trajnimi mbi çështjet e sigurisë dhe shkëmbim eksperience. Kursi u ndoq nga drejtues të sigurisë fizike të të gjitha bankave anëtare dhe adresoi çështje të organizatave të aviacionit civil dhe objektivat e tyre.



Kurs përgatitor për “Menaxhimin e Projekteve” sipas Guidës PMBOK®, 22-26 tetor 2012

AAB, në bashkëpunim me MDA në Kosovë, përfaqësues të Project Management Institute (PMI) SHBA, organizuan në Tiranë një kurs intensiv 5-ditor përgatitor për PMP, që ofron të gjitha njohuritë e duhura për të kompletuar testin PMP Edicioni 4 apo testin CAPM (Bashkëpunëtor i Certifikuar në Menaxhimin e Projekteve). Kursi u ndoq nga 9 pjesëmarrës të bankave anëtare dhe nga Specialistja e Operacioneve të AAB.

## AAB - TË TJERA

Trajnim mbi “Roli i gjykatës në procedurën përbarimore të ekzekutimit të titujve ekzekutive - kontratave të huave bankare”, 23 nëntor 2012

AAB në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, organizoi në qytetin e Vlorës një trajnim mbi “Rolin e gjykatës në procedurën përbarimore të ekzekutimit të titujve ekzekutivë - kontratave të huave bankare”. Objektivi kryesor i këtij kursi ishin kontrata e huas bankare si titull ekzekutiv, lëshimi i urdhrat të ekzekutimit dhe procedura specifike e ekzekutimit të saj, kërkesa për pavlefshmëri të titullit ekzekutiv dhe veçoritë e këtij kontestimi gjyqësor. Trajnimi u ndoq nga gjyqtarë të Gjykatave të Shkallës së Parë dhe të Apelit.

Kurs trajnimi për gazetarë ekonomikë, 8 dhjetor 2012

AAB organizoi një kurs trajnimi me temë: “Guidë mbi çështjet kryesore të analizës statistikore për gazetarë”. Kursi u drejtua nga z. Neritan Sejmini dhe u ndoq nga gazetarë ekonomikë të medias së shkruar dhe vizive, si dhe u fokusua në vlerësimin e të dhënave statistikore, për t’u aftësuar në dallimin dhe përdorimin korrekt të statistikave dhe informacionit ekonomik.

Darka e Vitit të Ri e AAB-së, 19 dhjetor 2012

AAB me rastin e mbylljes së vitit 2012 organizoi priftjen tradicionale të vitit të ri, me bankierë dhe përfaqësues të bankave anëtare. Të ftuar në këtë mbrëmje ishin z. Ardian Fullani, guvernator i Bankës së Shqipërisë, përfaqësues të Bankës së Shqipërisë dhe z. Marko Skreb, ish-guvernator i Bankës Kombëtare të Kroacisë.



